

Zhdukja e njerëzve gjatë regjimit komunist

Përmbledhje punimesh



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri





Zhdukja e njerëzve gjatë regjimit komunist

Përmbledhje punimesh





Organization for Security and
Co-operation in Europe
Presence in Albania



Ky botim është pjesë e kontributit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për drejtësinë tranzitore, dhe është financuar nga Fondacioni Konrad Adenauer. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autoreve dhe nuk pasqyrojnë, domosdoshmërisht, qëndrimin zyrtar të Prezencës ose të Fondacionit Konrad Adenauer.

Pasqyra e Lëndës

| | |
|---|----|
| Personat e Zhdukur gjatë Regjimit Komunist në Shqipëri Standardet Ndërkombëtare dhe Konteksti Kombëtar - Mirela Bogdani | 7 |
| I. Standardet ndërkombëtare për personat e zhdukur” dhe viktimat e zhdukjes së detyruar” | 8 |
| II. Konteksti kombëtar për personat e zhdukur” dhe viktimat e zhdukjes së detyruar” | 26 |
| III. Përfundime..... | 47 |
| IV. Bibliografi | 50 |
| | |
| Një analizë sociologjike mbi përndjekjen politike dhe zhdukjen e njerëzve nga regjimi komunist - Teuta Starova | 53 |
| Hyrje..... | 54 |
| I. Përpjekje fillestare për veprimin e drejtësisë tranzitore në Shqipërinë paskomuniste. | 55 |
| II. Përmasat tragjike të shkeljes së të drejtave të njeriut në Shqipërinë komuniste dhe të njerëzve të zhdukur nga regjimi | 59 |
| III. Përndjekja politike e grave nën regjimin komunist | 64 |
| IV. Korniza ligjore dhe përpjekjet praktike zyrtare për kërkimin dhe gjetjen e njerëzve të zhdukur nga diktatura komuniste | 65 |
| V. Mbi shkaqet e vonësës së gjatë të kërkimit dhe gjetjes së njerëzve të zhdukur | 68 |
| VI. Sfidat madhore të së ardhmes | 72 |
| VII. Bibliografi..... | 73 |

Shkurtime

| | |
|----------------|---|
| KEDNj- | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut |
| DUDNj- | Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut |
| OKB- | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| CED- | Komiteti për Zhdukjet e Detyruara |
| KiE- | Këshilli i Evropës |
| ICMP- | Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur |
| GjNP- | Gjykata Ndërkombëtare Penale |
| KNKK- | Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq |
| ICPPED- | Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar |
| AIDSSH- | Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit |
| IML- | Instituti i Mjekësisë Ligjore |
| KRSH- | Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë |
| KP- | Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë |
| KPrP- | Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë |
| IIP- | Instituti i Integritit të të Përndjekurve |

Personat e Zhdukur gjatë Regjimit Komunist në Shqipëri

Standardet Ndërkombëtare
dhe Konteksti Kombëtar

Mirela Bogdani

7

ZHDUKJA E NJERËZVE GJATË REGJIMIT
KOMUNIST - PËRMBLEDHJE PUNIMESH

I. Standardet ndërkombëtare për “personat e zhdukur” dhe “viktimat e zhdukjes së detyruar”

A. KONCEPTI NDËRKOMBËTAR I “PERSONIT TË ZHDUKUR” DHE “VIKTIMËS SË ZHDUKJES SË DETYRUAR”

i. Koncepti i përgjithshëm

Koncepti i personit të zhdukur është i gjerë dhe shihet nga këndvështrime të ndryshme. Së pari, përkufizimi i personit të zhdukur nuk është gjithmonë i njëjtë në të gjitha vendet dhe legjislacionet. Sidoqoftë, sipas Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, nga ana subjektive, personi i zhdukur është kushdo të cilit nuk i dihet vendndodhja dhe që kërkohet nga një apo disa persona të tjerë. Termi “person i zhdukur” merr kuptim objektiv kur personi denoncohet si i zhdukur apo kur zbulohet një trup i paidentifikuar.¹

Nga këndvështrimi ligjor, disa legjislacione të brendshme përcaktojnë se duhen përbushur disa kushte që personi të konsiderohet “i zhdukur”. Për shembull, Ligji për Personat e Zhdukur² në Mbretërinë e Bashkuar përcakton tre kushte të rëndësishme: (a) personi nuk gjendet në vendbanimin e vet; (b) personi nuk gjendet në aktivitetet e përditshme; dhe (c) plotësohet kushti i parë ose i dytë. Kushti i parë plotësohet nëse nuk dihet asgjë për vendndodhjen e personit, ose nuk dihet me saktësi të mjaftueshme që të mundësojë kontaktin e personit për qëllime vendimmarrjeje lidhur me pasurinë apo çështjet financiare të tij. Kushti i dytë plotësohet kur personi nuk është në gjendje të marrë vendime lidhur me pasurinë apo çështjet financiare ose t’i komunikojë këto vendime me qëllim zbatimin e tyre (apo të dyja) dhe arsyeja e kësaj është diçka përtej kontrollit të personit, që nuk ka të bëjë me sëmundje, lëndim apo mungesë kapaciteti për të vepruar lidhur me çështjen (në kuptimin e Ligjit për Kapacitetin Mendor të vitit 2005 në Mbretërinë e Bashkuar).³

1 Për më shumë informacion shih faqen e internetit të ICMP-së: <https://www.icmp.int/the-missing/who-are-the-missing/>

2 Ligji për Personat e Humbur të Mbretërisë së Bashkuar, miratuar më 27 prill 2017: <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2017/27/enacted>

3 Neni 1(1), (2) dhe (3) i Ligjit për Personat e Humbur i vitit 2017.

Përkundër kësaj, e drejta ndërkombëtare humanitare i përcakton “personat e zhdukur” apo “personat e humbur” nga një tjetër këndvështrim (humanitar). Në këtë kuadër, personat e zhdukur cilësohen ata për të cilët familjet e tyre nuk kanë asnjë lajm ose që denoncohen të zhdukur, mbi bazën e informacioneve të besueshme, për shkak të një konflikti të armatosur ndërkombëtar apo jondërkombëtar, të një situatë dhune të brendshme, trazirash, fatkeqësish apo katastrofash natyrore.⁴

Siç u përmend më lart, koncepti i “personave të zhdukur” është i gjerë dhe përfshin një mori situatash në të cilat personi mund të konsiderohet i zhdukur. Ky punim fokusohet në një kategori specifike të personave të zhdukur në Shqipëri: *viktimat e zhdukjes së detyruar* gjatë regjimit komunist, si një nga kategoritë më të vogla ndër personat e zhdukur. “Zhdukja” përcaktohet si çdo situatë ku personat arrestohen, ndalohen ose rrëmbehen kundër vullnetit të tyre, apo privohen nga liria prej zyrtarëve të degëve apo niveleve të ndryshme të shtetit, apo prej grupeve të organizuara ose individëve privatë që veprojnë në emër të një qeverie me mbështetjen apo pëlqimin ose dijeninë e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të saj, që pasohet nga refuzimi për të treguar fatin apo vendndodhjen e personave në fjalë ose refuzim për të pranuar privimin e lirisë, çka i vendos këta persona jashtë mbrojtjes së ligjit.⁵

Regjimet autoritare, si regjimi komunist që sundoi Shqipërinë për rreth 45 vjet. përdornin praktikën e zhdukjes së detyruar” si instrument për të ushtruar kontroll shoqëror dhe politik. Për shkak se arrestimi apo burgosja e paligjshme binte ndesh me parimin e procesit të rregullt ligjor, familjet e personave që zhdukeshin prej shtetit nuk kishin mjete për të kërkuar informacion për familjarët e zhdukur. Vetëm pas rënies së komunizmit janë bërë përpjekje për të hedhur dritë mbi ngjarjet e pazbardhura dhe për të gjetur eshtrat e personave të zhdukur.⁶

ii. Rasti i veçantë i Shqipërisë

Nga nëntori 1944 deri në vitin 1991⁷ Shqipëria u sundua nga diktatura komuniste totalitare që njihet si një nga më të ashprat dhe të përgjakshmet në Evropën Lindore. Mbi bazën e “luftës së klasave”, një numër i madh njerëzish që akuzoheshin se nuk mbështesnin (siç duhet) komunizmin apo qoftë edhe udhëheqës të caktuar komunistë, u internuan, u burgosën dhe disa më pas u vranë, duke i larguar prej familjarëve, miqve dhe të njohurive. Sipas Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK), 5,577 burra dhe 450 gra u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan. Të shumta janë dëshmitë që tregojnë për të burgosur politikë që vdiqën në burgje apo në kampet e punës, kryesisht prej torturave apo shkaqeve të tjera, si vetëvrasia. Edhe në këto raste, trupi i viktimës nuk i kthehej

4 Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), *Parime udhëzuese. Model ligji për të zhdukurit*, 2009, neni 2.1.

5 Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, 18 dhjetor 1992.

6 Kjo temë shtjellohet më poshtë në këtë studim.

7 Kjo periudhë cilësohet regjim totalitar, siç përkufizohet në Ligjin nr. 10242 për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Ligjin nr. 45/2015 për Autoritetin e Dosjeve të ish-Sigurimit.

familjes, sepse në regjimin komunist trupi i të dënuarit mbetet në dispozicion të shtetit përgjatë dënimit, madje edhe pas vdekjes.⁸

Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri, numri i saktë i personave të zhdukur në periudhën 1945-1990 mbetet i paqartë, edhe pse shifra besohet të jetë diku te 6,000 persona.⁹ Që prej vitit 1991 autoritetet shqiptare kanë miratuar disa akte ligjore për të trajtuar çështjen e viktimave të regjimit komunist, por vazhdon të ketë paqartësi për fatin e personave të zhdukur dhe vendndodhjen e varreve të përbashkëta, si dhe familjeve të të zhdukurve u është dhënë pak ndihmë konkrete.¹⁰

Që nga kalimi në demokraci në vitin 1991, autoritetet shqiptare kanë ndërmarrë masa për të garantuar përmbushjen e të drejtave të familjeve të personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste. Në vitin 2018, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për të çuar përpara përpjekjet për gjetjen e personave të zhdukur gjatë komunizmit në Shqipëri nga 29 nëntori 1994 deri më 2 korrik 1991, si edhe në rrethana të tjera për të cilat Këshilli i Ministrave mund të kërkojë ndihmën e ICMP-së. Marrëveshja e Bashkëpunimit bazohet në dëshirën e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për të mbrojtur të drejtat e familjeve të personave të zhdukur, sidomos duke garantuar hetim efektiv lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur dhe rrethanat e zhdukjes së tyre.¹¹

B. ORGANET NDËRKOMBËTARE PËRGJEGJËSE QË MERREN ME ZHUKJEN E DETYRUAR

i. Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)

ICMP-ja është organizatë ndërkombëtare e ngritur në kuadrin e një traktati, me seli në Hagë të Vendeve të Ulëta. Mandati i saj është të sigurojë bashkëpunimin e qeverive dhe palëve të tjera për gjetjen e personave të zhdukur nga konfliktet, shkeljet e të drejtave të njeriut, fatkeqësitë natyrore, krimi i organizuar, emigracioni i paligjshëm dhe shkaqe të tjera, si dhe t'i ndihmojë në këtë drejtim. ICMP-ja është e vetmja organizatë ndërkombëtare me tagrin ekskluziv për të punuar për çështjen e personave të zhdukur. E krijuar në vitin 1996, në Samitin e G-7-s në Lion të Francës, ICMP-ja merret me zhvillimin e institucioneve dhe kapaciteteve të shoqërisë civile, promovimin e legjislacionit, forcimin e advokimit social dhe politik, si dhe ofrimin e ekspertizës

⁸ Udhëzues për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste, Autoriteti për informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, faqe 5.

⁹ Për më shumë informacion, shih faqen e internetit të ICMP-së: <https://www.icmp.int/where-we-work/europe/albania/>.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ Raport i ICMP-së: Shqipëria: Personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave, Sarajevë, 2 mars 2021. ICMP.GR.WB.152.6.W.doc, faqe 5.

teknike për gjetjen dhe identifikimin e të zhdukurve.¹² Më 15 dhjetor 2014, ministrat e Jashtëm të Vendeve të Ulëta, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Belgjikës dhe Luksemburgut nënshkruan Marrëveshjen për Statusin dhe Funkcionet e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (i njohur edhe si Traktati i ICMP-së), e cila i dha ICMP-së personalitet juridik ndërkombëtar të plotë. Traktati i ICMP-së përcaktoi strukturën e re organizative që përfshinte një Bord Komisionerësh, një Konferencë të Shteteve Palë dhe një organ ekzekutiv që drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

ICMP-ja e zhvillon aktivitetin në kontekste të ndryshme shoqërore, politike dhe kulturore, duke u angazhuar në të gjitha aspektet e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur, nga nxitja e përfshirjes së shoqërisë civile deri te dhënia e asistencës teknike dhe ndërtimi i kapaciteteve institucionale. ICMP-ja ka qenë aktive në rreth 40 shtete që janë përballur me numër të lartë personash të zhdukur si rezultat i fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu, luftërat, shkeljet në masë të drejtave të njeriut, krimi i organizuar dhe shkaqe të tjera.

Disa objektiva kryesore të ICMP-së janë:

- Punon me qeveritë që të zhvillojë kapacitetet e tyre institucionale për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur në mënyrë efikase dhe të paanshme.
- Ndihmon qeveritë të hartojnë legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të familjeve të të zhdukurve, si dhe punon me organizatat e shoqërisë civile që t'i fuqizojë për të mbrojtur të drejtat e tyre.
- Asiston procesin e drejtësisë me qëllim që qeveritë të hetojnë zhdukjet me një përjasje që respekton shtetin e së drejtës, si dhe ofron prova në gjykimet penale.
- Asiston qeveritë me punime në terren, pasi ICMP-ja është përfshirë në gërmimin e mbi 3.000 vendvarrimeve masive dhe të fshehta, si dhe ka udhëhequr zbatimin e teknikave të avancuara mjekoligjore për gjetjen dhe rikuperimin e personave të zhdukur.
- Administron të gjitha të dhënat e personave të zhdukur, duke mbajtur një Qendër Kërkimi Online (OIC), unike dhe të specializuar, si edhe Sistemin për Administrimin e të Dhënave Identifikuese (IDMS).
- Kryen identifikimin e ADN-së njerëzore në një laborator bioinformatik lider në botë. Deri më sot, mbi 20.000 persona të zhdukur nga tërë bota janë identifikuar nga ADN-ja me ndihmën e ICMP-së.
- Ofron programe trajnimi dhe arsimimi/edukimi për një gamë të gjerë individësh, autoritete shtetërore, prokurorë dhe gjyqtarë, OJF, familjet e të zhdukurve dhe profesionistët mjekoligjorë.

ii. Komiteti për Zhdukjet e Detyruara

Komiteti për Zhdukjet e Detyruara (CED)¹³ u krijua nga Konventa për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (ICPPED) (shih më poshtë) në Pjesën e Dytë të saj. Komiteti është një organ me ekspertë të pavarur që monitoron zbatimin e ICPPED-së nga shtetet palë. Komiteti dhe Sekretariati i tij punojnë përditë për të mbështetur viktimat, organizatat e shoqërisë civile, institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe shtetet, që të kërkojnë dhe gjejnë personat e zhdukur, ta çrrënjoshin, dënojnë dhe parandalojnë këtë krim, si dhe të riparojnë dëmin e pësuar prej viktimave.¹⁴ Ai ka kompetencë vetëm për zhdukjet e detyruara që filluan pas hyrjes në fuqi të ICPPED-it.¹⁵

Komiteti përbëhet nga 10 ekspertë me karakter të lartë moral dhe kompetencë të konfirmuar në fushën e të drejtave të njeriut, të cilët shërbejnë në bazë të cilësive personale, si dhe janë të pavarur dhe të paanshëm. Anëtarët e Komitetit kanë mandate 4-vjeçare dhe zgjidhen nga shtetet palë sipas një shpërndarjeje gjeografike të drejtë. Vëmendje e veçantë i kushtohet pjesëmarrjes së dobishme në punën e Komitetit prej personave që kanë përvojën e duhur juridike, si edhe përfaqësimit të baraspeshuar gjinor.¹⁶ Secili shtet palë i paraqet Komitetit, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, një raport për masat e marra nga shteti palë në fjalë për realizimin e detyrimeve sipas Konventës, brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi të ICPPED-së.¹⁷ Nëse Komiteti siguron informacion të besueshëm që tregon se një shtet palë po shkel rëndë dispozitat e kësaj Konvente, ka tagrin që pas këshillimit me Shtetin Palë në fjalë, t'u kërkojë një apo disa anëtarëve që të kryejnë një vizitë dhe t'i raportojnë pa vonesa. Pas vizitës, Komiteti i njofton shtetit palë vëzhgimet dhe rekomandimet e veta.¹⁸ Nga ana tjetër, nëse Komiteti siguron informacion që duket se përmban fakte se po ushtrohet zhdukje e detyruar në mënyrë të përhapur dhe sistematike në territorin nën juridiksionin e shtetit palë, atëherë mund ta sjellë urgjentisht çështjen në vëmendje të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.¹⁹

iii. Grupi i Punës për Zhdukjen e Detyruar apo të Pavullneshme

Grupi i Punës për Zhdukjen e Detyruar apo të Pavullneshme (WGEID)²⁰ është një prej procedurave tematike të posaçme që mbikëqyren nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Me rezolutën 20 (XXXVI) të 29 shkurtit 1980, Komisioni për të

13 Për më shumë informacion, shih: <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/ced/pages/cedindex.aspx>

14 Po aty.

15 ICPPED, neni 35.

16 ICPPED, neni 26.

17 ICPPED, neni 29.

18 ICPPED, neni 33.

19 ICPPED, neni 34.

20 Për më shumë informacion, shih: <https://ijrcenter.org/un-special-procedures/working-group-on-enforced-or-involuntary-disappearances/>

Drejtat e Njeriut vendosi të krijonte një grup pune me pesë ekspertë të pavarur që të shqyrtonte çështjet e zhdukjeve të detyruara apo të pavullnetshme të personave. Që atëherë, mandati i Grupit të Punës është ripërtërirë rregullisht.²¹

Qëllimi i Grupit të Punës është të ndihmojë familjet e personave të zhdukur për gjetjen e familjarëve të tyre. Ai komunikon me qeveritë lidhur me raste dhe kërkesa individuale, të cilat verifikohen prej shteteve dhe më pas informojnë Grupin e Punës mbi rezultatet. Duke vepruar si kanal komunikimi midis familjeve të personave të zhdukur dhe qeverive, Grupi i Punës ka arritur të vendosë dialog me shumë qeveri, pavarësisht nëse kanë ratifikuar instrumente juridike që parashikojnë procedurë ankimi nga individët për shkelje të të drejtave të njeriut.²²

Detyrat kryesore të Grupit të Punës janë:

- asiston familjet që të zbulojnë fatin dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre të zhdukur;
- përcjell rastet e zhdukjes së detyruar te qeveritë përkatëse;
- kryen vizita në shtete dhe raporton gjetjet e këtyre vizitave;
- merr pretendime për akte të zhdukjes së detyruar që mund të ngrihen në nivelin e krimeve ndaj njerëzimit;
- monitoron përparimin e shteteve në zbatimin e Deklaratës së OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (shih më poshtë);
- Bën komente të përgjithshme mbi përparimin e shteteve në zbatimin e Deklaratës së OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar;
- mbron familjarët e personave të zhdukur, avokatët e tyre, dëshmitarët e zhdukjeve apo familjet e tyre, pjesëtarët e organizatave të familjarëve dhe organizatat e tjera joqeveritare, aktivistët e të drejtave të njeriut apo individët që kanë lidhje me zhdukjet;
- raporton çdo vit te Këshilli i të Drejtave të Njeriut për veprimtarinë e vet, etj.

iv. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK)²³ është një organizatë e pavarur dhe neutrale që garanton mbrojtje humanitare dhe asistencë për viktimat e konflikteve të armatosura dhe situatave të tjera të dhunshme. Komiteti vepron në përgjigje të emergjencave dhe njëkohësisht promovon respektimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm. Puna e Komitetit bazohet në Konventat e Gjenevës të 1949-s, Protokollat Shtesë të saj, Statutet e saj dhe ato të

²¹ Zhdukjet e Detyruara ose të Pavullnetshme, Raporti nr. 6/Rev. 3, Komisioneri i OKB-së për Të Drejtat e Njeriut, faqe 11.

²² Po aty.

²³ Për më shumë informacion, shih: <https://www.icrc.org/en/mandate-and-mission>

Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe Lëvizjes së Gjysmëhënës së Kuqe, si edhe rezolutat e Konferencave Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe.²⁴

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq punon për gjetjen e personave të denoncuar si të zhdukur dhe vendosjen sërish të kontakteve me familjarët. Këtu përfshihet kërkimi për familjarët, rivendosja e kontakteve, ribashkimi i familjeve dhe zbardhja e fatit të atyre që rezultojnë ende të zhdukur. Në situata konflikti, Komiteti promovon plotësimin e kërkesave për gjurmim nga familjarët e personave të zhdukur dhe ua paraqet këto kërkesa autoriteteve që mund të kenë informacion për personat e kërkuar.²⁵ Në këtë drejtim, në vitin 2003, Komiteti organizoi një konferencë ndërkombëtare për trajtimin e problemit të personave të zhdukur dhe për gjetjen e mënyrave për të ndihmuar familjet dhe komunitetet e prekura, me një pjesëmarrje të gjerë nga organizatat e të drejtave të njeriut, qeveritë, ekspertët dhe shoqatat e familjarëve të të zhdukurve. Konferenca ritheksoi nevojën për të ditur fatin e personave të zhdukur, e mishëruar tashmë në të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke identifikuar masat konkrete që mund të ndërmarrin palët në konflikt për parandalimin e zhdukjeve, si për shembull, respektimi dhe mbrojtja e civilëve dhe administrimi i duhur i të dhënave të personave. Gjithashtu, konferenca evidentoi rolin thelbësor të mjekësisë ligjore dhe trajtimin e duhur të eshtrave njerëzore. Për më tepër, njohu rolin jetik të rrjeteve që rivendosin lidhjet familjare, në të cilat janë përfshirë Komiteti, Kryqi i Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe, si dhe shumë shoqata të familjeve të të zhdukurve.²⁶

Komiteti ka realizuar shërbimin e gjurmimit online për rastet e emergjencave të mëdha. Familjarët mund të kërkojnë informacion për të dashurit e tyre përmes këtij shërbimi, i cili funksionon për personat e denoncuar si të zhdukur, si në rastin e konflikteve në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë*.²⁷

C. PERSONAT E ZHDUKUR (HUMBUR) GJATË REGJIMEVE KOMUNISTE

Shoqëritë e dala nga regjimet totalitare, si ai komunist, duhet të përballen me një trashëgimi dhunimi të të drejtave të njeriut, përfshirë zhdukjen e detyruar. Besohet se përballja me të kaluarën me dhunime masive duhet të jetë parakusht i nevojshëm për vendosjen e shtetit të së drejtës dhe pajtimin”.²⁸ Kërkimi i personave të zhdukur shpesh është një hap i parë i rëndësishëm në një proces të tillë dhe përparësi

24 <https://www.icrc.org/en/what-we-do/restoring-family-links>

25 Personat e zhdukur dhe viktimat e zhdukjes së detyruar në Evropë, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, mars 2016.

26 Për më shumë informacion, shih: <https://www.icrc.org/en/document/protected-persons/missing-persons>

* Të gjitha referencat për Kosovën, qofshin ato për territorin, institucionet apo popullsinë, duhen kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

27 Për më shumë informacion, shih: Personat e zhdukur dhe viktimat e zhdukjes së detyruar në Evropë, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, mars 2016, faqe 31.

28 J. Sisson, Anne-Marie La Rosa dhe Monique Crettol, “Drejtesia e Munguar dhe Trajtozë: E drejta për të ditur dhe lufta ndaj pandëshkueshmërisë”, Relacion Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Vëllimi 88, nr. 862, 2006, gjendet në: www.icrc.org/en/international-review/article/missing-and-transitional-justice-right-know-and-fight-against-impunity

immediate për familjarët dhe viktimat.

Nevoja për dënim ndërkombëtar të krimeve të regjimeve komuniste totalitare është shpallur në Rezolutën 1481 (2006) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.²⁹ Nga këndvështrimi i të drejtave ndaj zhdukjes së detyruar, Rezoluta parashikon se:

- Regjimet komuniste totalitare që sunduan në Evropën Qendrore dhe Lindore në shekullin e fundit dhe që janë ende në pushtet në mjaft vende të botës, janë karakterizuar, pa përjashtim, nga dhunime masive të të drejtave të njeriut. Dhunimet variojnë sipas kulturës, vendit dhe periudhës historike dhe përfshijnë vrasje dhe ekzekutime individuale dhe kolektive, vdekje në kampe përqendrimi, urinë, internimin, torturimin, punën skllavëruese dhe forma të tjera të terrorit fizik në masë, persekutim mbi baza etnike apo fetare, shkelje të lirisë së ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes, lirisë së shtypit, si edhe mungesën e pluralizmit politik;
- Krimet janë justifikuar në emër të teorisë së luftës së klasave dhe diktaturës së proletariatit. Interpretimi i këtyre dy parimeve legjitimonte eliminimin” e personave që ishin të dëmshëm për krijimin e shoqërisë së re dhe, si të tillë, ishin armiq të regjimeve komuniste totalitare. Një numër i madh i viktimave në secilin shtet ishin qytetarë të tyre;
- Rënia e regjimeve komuniste totalitare në Evropën Qendrore dhe Lindore nuk është pasuar në të gjitha rastet me hetim ndërkombëtar të krimeve të kryera prej tyre. Për më tepër, autorët e këtyre krimeve ende nuk janë sjellë në gjyq nga komuniteti ndërkombëtar;
- Ndërgjegjësimi për historinë është një prej parakushteve për mospërsëritjen e krimeve të tilla në të ardhmen. Për më tepër, vlerësimi dhe dënimi moral i krimeve luajnë rol të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj. Pozicionimi i qartë i komunitetit ndërkombëtar ndaj të kaluarës mund të jetë pikë referimi për veprimet e tij në të ardhmen;
- Viktimat e krimeve të regjimeve komuniste totalitare, të cilat janë vetë gjallë ose familjet e tyre, meritojnë solidaritet, mirëkuptim, njohje të vuajtjeve të tyre, etj.

Një instrument juridik i rëndësishëm që dënon krimet e kryera në emër të komunizmit është Deklarata e Pragës për Ndërgjegjen Evropiane dhe Komunizmin,³⁰ e iniciuar nga qeveria çeke dhe e nënshkruar më 3 qershor 2008 nga politikanë evropianë, ish të burgosur politikë dhe historianë. Edhe pse kjo Deklaratë nuk është detyruese për shtetet, ka marrë shumë mbështetje nga politikanë të shquar. Qëllimi kryesor i Deklaratës së Pragës është kriminalizimi i komunizmit. Për sa i përket zhdukje së detyruar, kjo Deklaratë bën thirrje për:

29 Rezoluta 1481 (2006) e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17403>

30 Shih tekstin e plotë të Deklaratës së Pragës në: <https://www.legal-tools.org/doc/e123be/pdf/>

- Arritjen e një mirëkuptimi mbarëevropian se regjimet totalitare naziste dhe komuniste duhet të gjykoen për bëmat e tmerrshme dhe se ato ndiqnin politika shkatërruese me zbatimin sistematik të formave ekstreme të terrorit, shtypjes së të gjitha lirive civile dhe njerëzore, fillimin e luftërave agresive dhe shfarosjen e internimin e kombeve të tjera, si dhe të grupeve të popullatave, ku të gjitha këto janë pjesë e pandashme e ideologjisë së këtyre regjimeve; dhe si të tillë duhet të konsiderohen si fatkeqësi kryesore të shekullit XX, çka çon në pranimin se shumë krime të kryera në emër të komunizmit duhet të vlerësohen si krime ndaj njerëzimit, duke shërbyer si paralajmërim për brezat e ardhshëm, në të njëjtën mënyrë si u vlerësuan edhe krimet naziste në Gjykatën e Nurembergut;
- Miratimin e legjislacionit që u mundëson gjykatave të ligjit të gjykojnë dhe të dënojnë autorët e krimeve të komunizmit dhe të kompensojnë viktimat e komunizmit;
- Presion evropian dhe ndërkombëtar për dënimin efektiv të krimeve komuniste në të kaluarën dhe luftë efikase ndaj krimeve komuniste që vazhdojnë, etj.

D. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE KRYESORE PËR ZHUKJEN E DETYRUAR

i. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut: Dhunimet lidhur me zhdukjen e detyruar

Deklarata Universal e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)³¹ është një nga instrumentet juridike më të rëndësishme për të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Hartuar nga përfaqësues me sponde të ndryshme juridike dhe kulturore nga të gjitha anët e botës, Deklarata u shpall nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Paris, më 10 dhjetor 1948, si një standard i përbashkët për t'u arritur nga të gjithë popujt dhe kombet. Për herë të parë parashikoi se të drejtat themelore të njeriut gëzojnë mbrojtje universale.

DUDNJ përcakton një sërë të drejtash ndërkombëtare të njeriut, të cilat mund të kategorizohen së paku në dy grupe kryesore: së pari, *të drejtat civile dhe politike* dhe së dyti, *të drejtat ekonomike, kulturore dhe sociale*. Zhdukja e detyruar e personave cilësohet si shkelje e të drejtave themelore të njeriut që u përkasin të dy grupeve më lart. Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut shprehet në Raportin për Zhdukjet e Detyruara apo të Pavullnetshme³² se gjatë zhdukjes mund të cenohen të drejtat *civile ose politike* si më poshtë:

31 Për më shumë informacion mbi tekstin e plotë të Deklaratës, shih: <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

32 Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Raporti nr. 6, versioni 3, Zhdukja e Detyruar ose e Pavullnetshme, qershor 2009.

- E drejta e njohjes si person para ligjit;
- E drejta e personit për liri dhe siguri;
- E drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese;
- E drejta e jetës, kur personi i zhdukur vritet;
- E drejta për identitet;
- E drejta për proces të rregullt ligjor dhe garanci gjyqësore;
- E drejta për mjete juridike efektive, përfshirë kompensimin dhe dëmshpërblimin;
- E drejta për të ditur të vërtetën lidhur me rrethanat e zhdukjes.³³

Nga ana tjetër, i njëjti Raport thekson se zhdukja e detyruar lidhet me shkeljen e të drejtave të tjera ekonomike, sociale dhe kulturore, jo vetëm të viktimave të zhdukura, por edhe të familjarëve të tyre. Këto të drejta të shkelura janë:

- E drejta e familjes për mbrojtje dhe ndihmë;
- E drejta për nivel të përshtatshëm jetese;
- E drejta e shëndetit;
- E drejta e arsimimit.³⁴

Zhdukjet mund të përbëjnë edhe shkelje të rënda të instrumenteve ndërkombëtare që nuk janë konventa, të tilla si: *Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve*, miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së në vitin 1957; *Kodi i Sjelljes për Oficerët Ligjzbatues dhe Korpusi i Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga çdo Formë Paraburgimi ose Burgimi*, miratuara nga Asambleja e Përgjithshme përkatësisht në vitet 1979 dhe 1988.³⁵

ii. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut: nenet për zhdukjen e detyruar dhe përqasja e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)³⁶ është një instrument juridik kryesor që mbron të drejtat e njeriut dhe liritë në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, e nënshkruar nga të 47 anëtarët e saj.³⁷ Kjo e bën KEDNj-në pjesë të sistemit të brendshëm juridik të shteteve nënshkruese. Konventa garanton të

33 Po aty, faqe 8.

34 Po aty, faqe 9.

35 Shih edhe: Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Raporti nr. 6, versioni 3, Zhdukja e Detyruar ose e Pavullnetshme, qershor 2009.

36 Për më shumë informacion mbi tekstin e plotë të Konventës, shih: https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf

37 Për më shumë informacion mbi listën e Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, shih: <https://www.coe.int/en/web/portal/47-members-states>

drejta dhe liri specifike, si dhe ndalon praktikat e padrejta dhe të dëmshme, ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata) zbaton dhe mbron të drejtat dhe garancitë e parashikuara në KEDNJ.

KEDNJ nuk ka një nen posaçërisht për zhdukjen e detyruar të personave. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se zhdukja e detyruar nuk parashikohet në konventë. Në fakt, zhdukja e detyruar aktivizon një sërë të drejtash të parashikuara në nenet e KEDNj-së.

Së pari, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut analizon rastet e zhdukjes së detyruar në lidhje me **nenin 2 të KEDNJ-së** (E drejta për jetën), që parashikon se:

1. *E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.*
2. *Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:*
 - (a) *në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;*
 - (b) *për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;*
 - (c) *për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”*

Gjykata zbaton prezumimin e shkeljes së anës materiale të nenit 2 të KEDNJ-së kur viktimat është parë për herë të fundit në rrethana kërcënuese për jetën dhe shteti i paditur nuk jep shpjegime për fatin apo vendndodhjen e personit.³⁸ Kur zhdukja ndodh në këto rrethana, detyrimi i shtetit për të kryer hetim efektiv dhe për të identifikuar dhe proceduar fajtorët nuk shuhet deri në zbulimin e trupit ose prezumimin e vdekjes. Në raste të veçanta, Gjykata ka shqyrtuar nëse shteti i paditur ka ndërmarrë masa operative efektive për të mbrojtur të drejtën për jetën të personit të zhdukur, siç kërkojnë detyrimet pozitive që rrjedhin prej nenit 2 të KEDNJ-së.³⁹

Është e rëndësishme të theksohet se Gjykata mund ta ngarkojë me përgjegjësi shtetin e paditur vetëm në rastet kur ekziston lidhje kohore reale ndërmjet këtyre shkeljeve dhe hyrjes në fuqi të KEDNJ-së në atë shtet. Për shembull, Shqipëria e ka ratifikuar KEDNJ-në në vitin 1996. Prandaj, Gjykatës mund t'i mungojë kompetenca për shqyrtimin e ankesave që lidhen me shkelje të nenit 2 në Shqipëri lidhur me zhdukjet e detyruara të ndodhura para vitit 1996. Sidoqoftë, Gjykata është shprehur edhe se detyrimi *procedural* që lind nga neni 2 i KEDNJ-së është i ndarë dhe autonom nga ana materiale dhe mund të konsiderohet si “i shkëputur”, duke qenë detyruar për shtetet edhe kur zhdukja apo vdekja e viktimës ka ndodhur para hyrjes në fuqi

38 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Qipro k. Turqisë, vendimi i 10 majit 2001.

39 Personat e zhdukur dhe viktimat e zhdukjes së detyruar në Evropë, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, mars 2016, faqe 37.

të KEDNj-së në shtetin në fjalë. Detyrimi procedural vazhdon për aq kohë sa është e arsyeshme të nevojitet për *sqarimin e rrethanave* të shkeljes dhe konstatimin e përgjegjësisë.⁴⁰

Së dyti, rastet e zhdukjes së detyruar lidhen me shkeljet e **nenit 3** të KEDNj-së (Ndalimi i torturës). Ky nen parashikon se:

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

Ky nen mund të zbatohet jo vetëm për vetë viktimat e zhdukjes së detyruar, por edhe për familjarët e tyre. Për sa u përket *viktimave të drejtpërdrejta*, Gjykata nuk e kalon barrën e provës për një shkelje të pretenduar të anës materiale të nenit 3 të KEDNj-së lidhur me një person të zhdukur, as nuk zbaton ndonjë prezumim; përkundrazi, u kërkon ankuesve të vërtetojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se familjari i tyre është torturuar.⁴¹ Gjykata shpesh u ka kërkuar shteteve të paditura të paraqesin kopje të dosjeve të hetimeve penale, por bashkëpunimi nga ana e autoriteteve ka qenë i pakënaqshëm. Në këto raste, Gjykata ka konstatuar shkelje të detyrimit të shtetit për të dhënë të gjitha materialet e nevojshme për shqyrtimin e ankesave, në shkelje të nenit 38 të KEDNj-së.⁴²

Nga ana tjetër, neni 3 i KEDNj-së mund të zbatohet për të mbrojtur familjarët, madje edhe të afërmit e viktimave të zhdukjes së detyruar. Gjatë vlerësimit të shkeljes së pretenduar, Gjykata mban parasysh:

- *Afërsinë* e lidhjeve familjare;
- *Rrethanat* e marrëdhënies;
- Masën në të cilën familjari *ka qenë dëshmitar i ngjarjeve* në fjalë;
- *Përfshirjen* e familjarit në përpjekjet për të siguruar informacion për zhdukjen;
- Faktin se duhet të kenë lindur *përpara kohës* kur ka ndodhur zhdukja e detyruar.⁴³

Së treti, zhdukja e detyruar lidhet me shkeljet e **nenit 5** të KEDNj-së (E drejta për liri dhe siguri) që parashikon se:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

(a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

40 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Šilih k. Sllovenisë, vendimi i 9 prillit 2009, pikat 157-160.

41 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Zaurbekova dhe Zaurbekova k. Ruisë*, vendimi i 22 janarit 2009, pikat 91 dhe 92.

42 Personat e zhdukur dhe viktimat e zhdukjes së detyruar në Evropë, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, mars 2016, faqe 40.

43 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Janowiec dhe Tjerë k. Ruisë*, vendimi i 16 prillit 2012, pikat 151 deri 154.

(b) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

(c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

(d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikëqyrrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

(e) kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

(f) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim".

Ky nën trajton drejtpërdrejtë shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhin në të gjitha rastet e zhdukjes së detyruar. Pavarësisht disa përpjekjeve të rralla, Gjykata zakonisht nuk e trajton të drejtën për liri të ndarë nga e drejta për siguri.⁴⁴

Njësoj si me nenet 2 dhe 3 të KEDNj-së, Gjykata thekson dallimin ndërmjet anës materiale dhe procedurale të nenit 5. Ana materiale e nenit 5 u dikton shteteve anëtare detyrimin që të respektojnë të drejtën e personit për liri dhe siguri. Gjykata ka konstatuar se Përderisa kanë marrë kontrollin mbi individët, autoriteteve u takon të mbajnë përgjegjësi për vendndodhjen e tyre. Për këtë arsye, neni 5 duhet të interpretohet se autoritetet kanë detyrimin të marrin masa efektive për mbrojtjen ndaj rrezikut të zhdukjes dhe të realizojnë një hetim efektiv të menjëhershëm kurdo

44 Shih edhe: Kyriakou, Nikolas, Një përballje me ndërgjegjen e njerëzimit: Zhdukja e detyruar në të drejtën ndërkombëtare humanitare, *European University Institute*, Firenze, qershor 2012.

që ka një pretendim të bazuar se dikush është paraburgosur dhe që atëherë nuk është parë më”.⁴⁵ Nga ana tjetër, ana procedurale e nenit 5 i detyron shtetet anëtare të kryejnë hetim efektiv për zhdukjen e një personi që konstatohet se ka qenë nën kontrollin e tyre.

Së fundmi, zhdukja e detyruar aktivizon të drejtën e palëve të dëmtuara që të kërkojnë dëmshpërblim sipas **nenit 13** të KEDNj-së (E drejta për zgjidhje efektive), që parashikon se:

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Qëllimi i zgjidhjes dhe dëmshpërblimit është *restitutio in integrum* dhe, kur kjo është e pamundur, kompensimi dhe forma të tjera të dhura dhe të përshtatshme të kompensimit.⁴⁶ Si pjesë e së drejtës për zgjidhje efektive dhe dëmshpërblim, viktimat, në shumicën e rasteve familjarët e tyre, kanë të drejtë të dinë të vërtetën e rrethanave të zhdukjes së detyruar, ecurinë dhe rezultatet e hetimit, si dhe fatin e personit të zhdukur. Gjykata ka theksuar se kur familjet kanë një pretendim të bazuar se familjari i tyre është zhdukur në duart” e autoriteteve, apo kur bëhet fjalë për një të drejtë me rëndësi thelbësore, siç është e drejta për jetën, neni 13 kërkon që, përveç pagimit të kompensimit sipas rastit, të kryhet edhe një hetim i plotë dhe efektiv, i aftë që të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, si edhe qasje efektive të familjarëve në procedurën hetimore.⁴⁷ Kjo njihet ndryshe edhe si e drejta për të vërtetën”. Mjeti juridik më lart, që kërkohet nga neni 13 i KEDNj-së, duhet të jetë *efektiv* në praktikë dhe në ligj, sidomos në kuptimin që ushtrimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustificuar nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve të shtetit të paditur.⁴⁸

Megjithatë, Gjykata është përballur me kritika të ashpra për përjasjen e saj të shtrënguar, për shkak të dëmshpërblimeve në vlera të ulëta që u ka njohur familjarëve të viktimave të zhdukjes së detyruar.

iii. Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar

Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (këtej e tutje Deklarata e OKB-së”) u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së përmes Rezolutës 47/133 të 18 dhjetorit 1992 dhe të përfunduar në vitin 2006.⁴⁹ Ajo është shpallur si nj *korpus parimesh* për të gjitha shtetet dhe nuk është dokument juridikisht detyrues, por ka pasur ndikim të madh në sensibilizimin

45 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Kurt k. Turqisë*, vendim i vitit 1998.

46 Mujkanovic dhe Të Tjerë k. Bosnjë-Hercegovinës, Ankesa nr. 47063/08.

47 Tanis dhe Të Tjerë k. Turqisë, Ankesa nr. 65899/01, pika 235.

48 Ipek k. Turqisë, Ankesa nr. 25760/94, pika 197.

49 Për më shumë informacion mbi tekstin e plotë të Deklaratës, shih: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/enforceddisappearance.aspx>

mbi të drejtat e viktimave të zhdukjes së detyruar dhe familjarëve të tyre, si dhe në hartimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (shih më poshtë).

Deklarata parashtron *përkufizimin* e zhdukjes së detyruar, duke e përshkruar si një situatë ku *personat arrestohen, ndalohen ose rrëmbehen kundër vullnetit të tyre apo privohen nga liria prej zyrtarëve të degëve apo niveleve të ndryshme të shtetit, apo prej grupeve të organizuara ose individëve privatë që veprojnë në emër të një qeverie me mbështetjen apo pëlqimin ose dijeninë e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të saj, që pasohet nga refuzimi për të treguar fatin apo vendndodhjen e personave në fjalë ose refuzimi për të pranuar privimin e lirisë, çka i vendos këta persona jashtë mbrojtjes së ligjit*.⁵⁰

Gjithashtu, Deklarata e OKB-së parashikon një sërë instrumentesh juridike ndërkombëtare, dispozitat e të cilave shkelen prej akteve të zhdukjes së detyruar, si për shembull: Konventa e Gjenevës e 12 gushtit 1949 dhe Protokollet Shtesë të saj të vitit 1977; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (sidomos e drejta për jetën, e drejta për liri dhe siguri e personit, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe e drejta e njohjes si person para ligjit); Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese; Kodi i Sjelljes për Oficerët Ligjzbatues; Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Oficerët Ligjzbatues; Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Abuzimit me Pushtetin, Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, etj.

Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar e cilëson çdo akt të zhdukjes së detyruar si shkelje penale të dinjitetit njerëzor, që dhunon, ndër të tjera: të drejtën e njohjes si person para ligjit; të drejtën e personit për liri dhe siguri, të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, si dhe përbën një kërcënim të rëndë ndaj të drejtës për jetën.⁵¹ Në këtë drejtim, shtetet jo vetëm kanë detyrimin, sipas kësaj Deklarate, *që të mos ushtrojnë, lejojnë apo tolerojnë* zhdukjet e detyruara, por edhe *të kontribuojnë me të gjitha mjetet* për parandalimin dhe çrrënjosjen e zhdukjes së detyruar. Gjithashtu, ato kanë detyrimin të marrin masa *efektive* legjislative, administrative, gjyqësore dhe të tjera që të parandalojnë dhe t'i japin fund akteve të zhdukjes së detyruar në territorin nën juridiksionin e tyre.⁵² Për më tepër, Deklarata ngarkon me përgjegjësi të trefishtë shtetet e përfshira në zhdukjen e detyruar, sepse thekson se shtetet apo autoritetet shtetërore që organizojnë, lejojnë apo tolerojnë zhdukje të tilla mbajnë përgjegjësi *penale* dhe *civile*, pa paragjykuar *përgjegjësinë ndërkombëtare* të shtetit në fjalë sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare.⁵³

Për sa u përket personave që marrin pjesë në aktet e zhdukjes së detyruar, Deklarata parashikon se ata do të sillen para autoriteteve civile përgjegjëse të atij shteti që të *procedohen penalisht* dhe të dalin në gjyq, përveç se kur i akuzuari është ekstraduar

50 Pika 3 e pjesës hyrëse.

51 Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, neni 1

52 Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, neni 3.

53 Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, nenet 4 dhe 5.

në një tjetër shtet që dëshiron të ushtrojë juridiksionin sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi. Të gjitha shtetet duhet të ndërmarrin çdo veprim të ligjshëm dhe të përshtatshëm në dispozicion të tyre, për të çuar para drejtësisë të gjithë personat e prezumuar si përgjegjës për një akt të zhdukjes së detyruar, të cilët konstatohen se janë brenda juridiksionit apo kontrollit të shtetit.⁵⁴ Përveç kësaj, personat që dyshohen se kanë kryer akte të tilla duhet të pezullohen nga çdo funksion zyrtar gjatë hetimit; duhet të gjykojnë vetëm nga gjykatat e zakonshme përgjegjëse të secilit shtet; nuk duhet t'u jepen privilegje, imunitet apo përjashtime të posaçme; nuk duhet të përfitojnë nga ndonjë ligj i posaçëm amnistues apo masa të ngjashme që mund të kenë efektin e përjashtimit të tyre nga procedimi penal apo sanksionet penale, etj. Sidoqoftë, ata gëzojnë të drejtën për trajtim të barabartë në përputhje me dispozitat përkatëse të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.⁵⁵

Për më tepër, Deklarata fokusohet te të drejtat e viktimave të zhdukjes së detyruar dhe familjarët e tyre. Ajo përcakton të drejtën për *zgjdhje gjyqësore të shpejtë dhe efektive*, si mjet për përcaktimin e vendndodhjes apo gjendjes shëndetësore të presonit të privuar nga liria dhe/ose për evidentimin e autoritetit që ka urdhëruar dhe realizuar heqjen e lirisë⁵⁶; të drejtën e çdo personi të privuar nga liria që të mbahet në *një mjedis paraburgimi të njohur zyrtarisht*, si dhe të çohet para *një autoriteti gjyqësor menjëherë pas paraburgimit*⁵⁷ në përputhje me të drejtën e brendshme; të drejtën për *informim të saktë të familjarëve apo avokatit* lidhur me paraburgimin e personave të tillë, si dhe vendin e paraburgimit, përfshirë transferimin⁵⁸; të drejtën e ankimit pranë autoritetit shtetëror kompetent dhe të pavarur, si edhe që ky ankim të hetohet prej këtij autoriteti në mënyrë të shpejtë, të plotë dhe të paanshme.⁵⁹

iv. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë personave nga Zhdukja e Detyruar (ICPPED)⁶⁰ u miratua me Rezolutën A/RES/61/177 të Asamblesë së Përgjithshme në dhjetor 2006 dhe hyri në fuqi më 23 dhjetor 2010. Në procesin trevjeçar të negociimit morën pjesë mbi 70 shtete, shumë OJF, shoqata e familjarëve të të zhdukurve dhe ekspertë.⁶¹ Shtetet që e ratifikojnë Konventën pranojnë efektin e saj ligjërishit dhe quhen shtete palë. Ky është i pari instrument botërisht detyruar për të drejtat e njeriut, që trajton posaçërisht zhdukjen e detyruar. Ai u parapri nga

54 Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, neni 14.

55 Po aty, neni 16.

56 Po aty, neni 9.

57 Po aty, neni 10 (1).

58 Po aty, neni 10 (2).

59 Deklarata e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, neni 13 (1).

60 Për më shumë informacion mbi tekstin e plotë të Konventës, shih: <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/ced/pages/conventionced.aspx>

61 Zhdukjet e Detyruara ose të Pavullnetshme, Raporti nr. 6/Rev. 3, Komisioneri i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, faqe 12.

Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (shih më lart), e cila mbetet referencë e rëndësishme si një korpus parimesh për të gjitha shtetet. Megjithatë, ICPPED-ja solli standarde të reja dhe forcoi ato që ishin përcaktuar në Deklaratën e OKB-së.

ICPPED përcakton në preambulë një listë të instrumenteve të tjera ndërkombëtare me të cilat ndërlidhet, si për shembull Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (sidomos nenet e analizuara më lart); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, etj. Ajo jep edhe përkufizimin e zhdukjes së detyruar, duke e cilësuar si *arrestimin, ndalimin, rrëmbimin apo çdo formë tjetër e privimit të lirisë nga agjentët e shtetit apo persona ose grupe personash që veprojnë me autorizimin, mbështetjen apo dijeninë e shtetit, e pasuar me refuzimin për pranimin e heqjes së lirisë apo fshehjen e fatit apo vendndodhjes së personit të zhdukur, çka e vendos personin jashtë mbrojtjes së ligjit*.⁶²

Përkufizimi më lart është shumë i ngjashëm me përkufizimin e Deklaratës së OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar, që është një shenjë e ndikimit të madh që pati Deklarata në hartimin e ICPPED-së. Sidoqoftë, ndryshe nga Deklarata e OKB-së që e përmend këtë përkufizim në preambulë, ICPPED-ja i ka kushtuar një nen të tërë këtij instituti. Gjithashtu, konventa riafirmon qëndrimin e Deklaratës së OKB-së se praktika e përhapur apo sistematike e zhdukjes së detyruar përbën krim ndaj njerëzimit.

ICPPED parashikon natyrën *absolute* të ndalimit të zhdukjes së detyruar, duke përcaktuar që në nenin e parë se asnjë rrethanë përjashtimore e çfarëdo lloji, qoftë gjendje lufte apo kërcënim për luftë, trazira të brendshme politike apo emergjenca të tjera publike, nuk mund të evokohet si justifikim për zhdukjen e detyruar.⁶³

- *Përgjegjësitë e shteteve nënshkruese sipas ICPPED-së*

Për sa u përket *përgjegjësi* të shteteve nënshkruese, ICPPED-ja thekson se ato duhet të marrin masa për të parandaluar çdo lloj zhdukjeje të detyruar. Së pari, shtetet nënshkruese duhet t'i garantojnë çdo personi me interes legjitim – qoftë familjar i personit të privuar nga liria, përfaqësuesve të tyre apo avokatit – **qasje në informacion** lidhur me heqjen e lirisë së personit.

Shteti nënshkrues që zbaton **parashkrimin** lidhur me zhdukjen e detyruar, duhet të marrë masat e nevojshme për të garantuar që parashkrimi të fillojë sa më vonë për procedimet penale dhe të jetë në përpjesëtim me këtë vepër penale të rëndë, si edhe të fillojë nga momenti kur kjo vepër penale e zhdukjes së detyruar shuhet, duke pasur parasysh natyrën vijuese të saj.⁶⁴ Gjithashtu, i njëjti nen thekson se është përgjegjësi e shtetit të garantojë të drejtën e viktimave të zhdukjes së detyruar për **zgjidhje efektive** gjatë afatit të procedimit.

Gjithashtu, secili shtet nënshkrues duhet të garantojë se çdo individ që pretendon se një person i është nënshtruar zhdukjes së detyruar të ketë **të drejtën të denoncojë faktet pranë autoriteteve kompetente**, të cilat duhet të shqyrtojnë pretendimet

62 ICPPED, neni 2.

63 ICPPED, neni 1(2).

64 ICPPED, neni 8.

në mënyrë të shpejtë dhe të paanshme dhe, kur është e nevojshme, të ndërmarrin pa vonesa **një hetim të plotë dhe të pavarur**.⁶⁵ Shtetet palë kanë detyrimin të bashkëpunojnë ngushtë mes tyre. Ato duhet t'i japin njëri-tjetrit masën maksimale të asistencës së ndërsjellë, me qëllim asistimin e viktimave të zhdukjes së detyruar, si dhe për kërkimin, gjetjen dhe lirin e personave të zhdukur dhe, në rast vdekjeje, për zhvarrosjen, identifikimin dhe kthimin e eshtrave të tyre.⁶⁶

- *Personat e përfshirë në kryerjen e akteve të zhdukjes së detyruar*

Gjithashtu, ICPPED-ja i vë theks të veçantë masave që duhen ndërmarrë ndaj *personave pjesëmarrës në aktet e zhdukjes së detyruar*. Ajo parashikon se secili shtet nënshkrues duhet të marrë masat e nevojshme për të ndjekur penalisht të paktën një person që kryen, urdhëron, përkrah apo nxit kryerjen apo tentativën e kryerjes së zhdukjes së detyruar, ose është bashkëpunëtor apo pjesëmarrës në të, ashtu edhe eprorët të cilit ishin në dijeni se vartësit e tyre do të kryenin akte të zhdukjes së detyruar.⁶⁷

- *Viktimat e zhdukjes së detyruar*

Është i rëndësishëm fakti se ICPPED-ja parashikon përkufizimin për viktimat e zhdukjes së detyruar”, duke shprehur se i referohet personit të humbur dhe çdo personi që pëson dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i zhdukjes së detyruar.⁶⁸ Përjasja për të cilësuar viktimat të zhdukjes së detyruar edhe familjarët e personave të zhdukur përbën risi ndër instrumentet ndërkombëtare. Këta të fundit gëzojnë të drejtën të dinë të vërtetën lidhur me rrethanat e zhdukjes së detyruar, ecurinë dhe rezultatet e hetimit, fatin e personit të zhdukur, si dhe të marrin dëmshpërblim dhe kompensim të shpejtë, të drejtë dhe të mjaftueshëm.⁶⁹ Në këtë drejtim, është e rëndësishme të nënvizojmë se e drejta e viktimës për kompensim interpretohet gjerësisht nga ICPPED-ja, duke parashikuar se e drejta për të përfituar dëmshpërblim përfshin *dëmin material dhe moral* dhe, sipas rastit, *edhe format e tjera të dëmshpërblimit* si rikthimi, rehabilitimi, kompensimi i drejtë, përfshirë rivendosjen e dinjitetit dhe reputacionit, si dhe garancitë e mospërsëritjes.⁷⁰

- *Komiteti për Zhdukjet e Detyruara*

Në pjesën e dytë, ICPPED-ja krijon *Komitetin për Zhdukjet e Detyruara* (shih më lart për një analizë më të hollësishme) për të ushtruar funksionet e parashikuara në këtë Konventë. Ky fakt përbën një ndryshim të madh ndërmjet Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar dhe Konventës më lart, sepse e para nuk parashikonte një organ monitorimi për zbatimin e saj. Për më shumë informacione mbi funksionet dhe anëtarësimin në këtë Komitet, shihni Seksionin I(b)(ii) të këtij studimi.

65 ICPPED, neni 12.

66 ICPPED, neni 15.

67 ICPPED, neni 6.

68 ICPPED, neni 24.

69 Po aty.

70 Po aty.

II. Konteksti kombëtar për personat e zhdukur” dhe viktimat e zhdukjeve me forcë”

E. PARASHIKIMET E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIDHUR ME NJERËZIT E HUMBUR DHE ZHUKJEN ME FORCË

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (KRSH)⁷¹ është ligji themeltar, më i lartë në hierarkinë e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë. Në kuadër të këtij studimi, është e rëndësishme të theksohet se kjo kushtetutë është hartuar, miratuar dhe ka hyrë në fuqi pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri. Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë të shprehur termin “zhdukje me forcë” apo “person i zhdukur”. Në fakt, i vetmi ligj në Shqipëri i cili parashikon një përkufizim të termit “person i zhdukur” është ligji Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”⁷², i cili parashikon se: “*Person i zhdukur, sipas fushës së veprimit të këtij ligji, është personi i arrestuar, i burgosur, i rrëmbyer ose të cilit i është hequr liria në çdo formë tjetër nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit*”.⁷³

Megjithatë, nëpërmjet **parimeve** që parashtron Kushtetuta, është e qartë që zhdukja me forcë është e papranueshme dhe e patolerueshme në nivel parimesh kushtetuese në Shqipëri. Që në Preambulë kjo Kushtetutë shprehet për “**garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror... me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit**”.

Në vijim të këtij qëndrimi, Kushtetuta parashikon në **Pjesën e Parë (Parime Themelore)** se: “**...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore ...janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë**”.⁷⁴ Në këtë nen

71 Ligji Nr. 8417, datë 22.11.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

72 Ky ligj do të analizohet më me hollësi në vijim.

73 Neni 1(8) i Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

74 Neni 3 i KRSH-së.

përcaktohet **detyrimi pozitiv** i shtetit në mbrojtje të dinjitetit dhe të drejtave të njeriut. Një veprim (si zhdukja me forcë) që do të cenonte të drejtën për jetën, lirinë kundër torturës, të drejtën për liri e siguri, të drejtën për një proces të rregullt ligjor etj., konsiderohet automatikisht si antikushtetues, në përputhje, së pari, me Nenin 3 të kësaj Kushtetute.

Pjesa e dytë e Kushtetutës i dedikohet tërësisht respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në këtë pjesë, sërish sanksionohet jo vetëm detyrimi negativ i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, por edhe detyrimi pozitiv i mbrojtjes së tyre në rast cenimi. Neni 15(2) i Kushtetutës parashikon që organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të **respektojnë** të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të **kontribuojnë për realizimin** e tyre. Kushtetuta i dedikon një nen të veçantë mbrojtjes së të drejtës për jetën. Neni 21 i saj përcakton se:

“Jeta e personit mbrohet me ligj”.

Gjithashtu, Kushtetuta sanksionon të drejtën kundër torturës në Nenin 25 të saj:

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.

Një vëmendje e posaçme i dedikohet në Kushtetutë të drejtës për liri e siguri. Neni 27 i KRSH-së përcakton:

1. *Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.*

2. *Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:*

a) *kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;*

b) *për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;*

c) *kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;*

ç) *për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;*

d) *kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;*

dh) *për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të*

ekstradimit.

3. *Askujt nuk mund t’i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.*

Duket se Kushtetuta e RSH-së dhe KEDNJ-ja ecin të të njëjtën linjë lidhur me garantitë që duhet të ofrohen në mbrojtje të së drejtës për liri e siguri.⁷⁵ Ky është një nen i gjerë që përfshin trajtimin e situatave të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të njeriut, por është veçanërisht i rëndësishëm në mbështetje të viktimave të zhdukjes me forcë, si dhe për të ndaluar përsëritjen e dhunimeve të tilla në të ardhmen.

F. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË RATIFIKUARA NGA SHQIPËRIA LIDHUR ME NJERËZIT E HUMBUR DHE ZHUKJEN ME FORCË

Një rol të rëndësishëm në kuadrin ligjor shqiptar luajnë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-ja, pasi vetë Kushtetuta e RSH-së në Nenin 116 të saj, i vendos në hierarki menjëherë pas Kushtetutës, mbi çdo ligj apo akt nënligjor. Po ashtu, vetë Kushtetuta garanton që Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.⁷⁶ Për sa i përket çështjes së zhdukjes me forcë të njerëzve gjatë periudhës së komunizmit, Shqipëria ka ende nevojë për akte të reja ligjore e nënligjore për trajtimin e plotë të problematikave të shkaktuara përgjatë një periudhe pothuaj gjysmëshekullore dhunimesh. Për këtë arsye, sidomos në këtë moment, është e rëndësishme që viktimat (apo pasardhësit e viktimave) të zhdukjes me forcë gjatë periudhës së komunizmit të kenë mundësi të mbështeten edhe te marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria lidhur me këtë çështje.

Detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë nënshkruese kanë një ndikim të madh në trajtimin e çështjeve që lidhen me personat e zhdukur me forcë. Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar disa nga marrëveshjet ndërkombëtare të rëndësishme në kuadër të trajtimit të çështjeve të lidhura me zhdukjen me forcë të personave, si më poshtë: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe ICMP-së, Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, etj.

i. Roli i KEDNJ-së në të drejtën e brendshme shqiptare lidhur me zhdukjen me forcë

Nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-ja është me rëndësi të veçohet Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), së cilës Kushtetuta e

75 Për më shumë informacion lidhur me parashikimet e KEDNJ-së mbi të drejtën për liri e siguri, shiko Nënkapitullin 1(d)(ii) të këtij studimi.

76 Neni 5 i KRSH-së.

RSH-së, në Nenin 17 të saj, i atribuon një status të veçantë dhe superior në krahasim me marrëveshje të tjera ndërkombëtare. Ky nen, në paragrafin 2, parashikon që kufizimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese nuk mund të cenohet thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalohet kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Pra, për sa i përket **kufizimit të të drejtave kushtetuese, KEDNJ-ja** qëndron në majën e hierarkisë të burimeve të së drejtës, së bashku me Kushtetutën.

Ashtu siç është përmendur më lart në këtë studim, vetë KEDNJ-ja nuk e trajton në një nen të veçantë problemin e zhdukjes me forcë. Megjithatë, interpretimet e GJEDNJ-së lidhur me nenin e KEDNJ-së që cenon zhdukja me forcë e njerëzve, kanë një rëndësi të madhe, pasi mund të përdoren drejtpërdrejt nga viktimat e zhdukjes me forcë (apo pasardhësit e tyre) në Shqipëri. Kështu, në përputhje me parashikimet e KEDNJ-së dhe interpretimet e GJEDNJ-së, zhdukja me forcë e njerëzve mund të cenohet të drejta si: e drejta për jetën, e drejta kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, e drejta për liri e siguri, e drejta për një dëmshpërblim efektiv etj.⁷⁷

ii. Roli i Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë në të drejtën e brendshme shqiptare

Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë është analizuar në këtë studim në kuadër të standardeve ndërkombëtare lidhur me fenomenin e zhdukjes me forcë. Megjithatë, është e nevojshme të trajtohet edhe një analizë e ndikimit të kësaj konvente në të drejtën e brendshme shqiptare. Kjo nevojë lind sidomos në kushtet kur, në mungesë të akteve shteruese nënligjore për trajtimin në praktikë të problemeve të zhdukjes me forcë gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, viktimat apo familjarët e tyre mund t'u referohen drejtpërdrejt edhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, në përputhje me Nenin 116 të Kushtetutës.⁷⁸

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë në 06.02.2007 dhe e ka ratifikuar atë në 08.11.2007.⁷⁹ Në përputhje me parashikimet e kësaj konvente, Shqipëria i nënshtrohet një sërë detyrimesh (të përmbledhura në pikën I(d)(iii) të këtij studimi), ndër të cilat, në rastin e Shqipërisë, është me rëndësi të përmendet Neni 12. Ky i fundit rendit një sërë garancish, të cilat përveçse u shërbejnë viktimave të zhdukjes me forcë apo familjarëve të tyre për t'u përdorur drejtpërdrejt para autoriteteve shqiptare, përbëjnë edhe detyrime ligjore për autoritetet kompetente për hetimin e këtij krimi, si prokuroritë dhe gjykatat.

⁷⁷ Për më shumë informacion lidhur me interpretimet e GJEDNJ-së lidhur me zhdukjen me forcë të njerëzve, shiko kapitullin 1(d)(Iii) të këtij studimi.

⁷⁸ Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë rendit marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara si pjesë të akteve normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të dytat për nga hierarkia, pas Kushtetutës.

⁷⁹ Para hyrjes zyrtare në fuqi të kësaj konvente.

Së pari, këto institucione duhet të marrin parasysh kërkesat e çdo individ që pretendon se ka ndodhur një zhdukje me forcë. Hetimet duhet të realizohen shpejt dhe në mënyrë të paanshme. Po ashtu, sipas kësaj konvente, institucioni kompetent, që në këtë rast është prokuroria, duhet të marrë masat që ankuesi, dëshmitarët, të afërmit e personit të zhdukur dhe avokati i tyre mbrojtës, si dhe personat që marrin pjesë në hetim, mbrohen nga çdo keqtrajtim ose kanosje si pasojë e ankesës ose ndonjë dëshmie të dhënë.⁸⁰ Është e rëndësishme të theksohet se edhe nëse nga ankuesit nuk është depozituar një ankesë formale, autoritetet kompetente (në rastin e Shqipërisë, prokuroria) duhet të nisin një hetim, në rastin kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se një person mund t'i jetë nënshtruar zhdukjes me forcë. Ky qëndrim është i rëndësishëm për t'u pasur parasysh nga prokuroria, e cila në këtë rast duhet të nisë hetimin *ex officio*. Ky qëndrim është në përputhje edhe me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale (që do të analizohen më në detaje më poshtë), i cili parashikon që prokurori, ndër të tjera, “kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm”⁸¹

Nga ana tjetër, në kuadër të mbarëvajtjes së punës hetimore, Shqipëria, si nënshkruese e kësaj konvente, ka detyrimin të sigurojë që prokuroria të ketë pushtet dhe burime të mjaftueshme për realizimin e hetimeve efektive në këtë fushë, si dhe qasje në vende ku mendohet se mund të jetë kryer zhdukja me forcë.⁸²

iii. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe ICMP-së

Ligji për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)⁸³ e bën këtë marrëveshje të rëndësishme tashmë pjesë të legjislacionit të brendshëm shqiptar. Marrëveshja përcakton bashkëpunimin midis Republikës së Shqipërisë dhe ICMP-së për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës 1944-1991, si dhe në rrethana të tjera për të cilat Këshilli i Ministrave mund të kërkojë ndihmën e ICMP-së. Ai gjithashtu përcakton statusin juridik dhe funksionet e ICMP-së në Shqipëri në përputhje me Konventën e Vjenës.⁸⁴

Fillimisht, marrëveshja i dedikon një hapësirë të veçantë dëshirës së dyanshme për bashkëpunim. Ajo nënvizon **dëshirën për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur**, veçanërisht duke siguruar që vendndodhja e të zhdukurve dhe rrethanat e zhdukjes së tyre të hetohen në mënyrë efektive; **referimin të traktatet për të drejtat e njeriut** në të cilat Shqipëria është palë, përfshirë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore

80 Neni 12(1) i konventës.

81 Neni 24(1) i KPrP-së.

82 Neni 12(3) i Konventës.

83 Ligji Nr. 83/2018 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

84 Për më shumë informacion, vizito faqen zyrtare në ICMP: <https://www.icmp.int/press-releases/icmp-and-government-of-albania-sign-cooperation-agreement/>

dhe Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë; **avancimin e përpjekjeve** për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, si dhe në rrethana të tjera për të cilat Këshilli i Ministrave mund të kërkojë ndihmën e ICMP-së.

Marrëveshja fokusohet gjithashtu në përcaktimin e **përgjegjësive dhe kompetencave të zyrës së ICMP-së në Shqipëri**. Ndër to janë të rëndësishme për t'u përmendur:⁸⁵

- Ndërmarrja e përpjekjeve për të **asistuar autoritetet shqiptare për përpilimin e listës së personave që janë zhdukur dhe anëtarëve të familjeve të tyre**, duke përdorur Qendrën e Kërkimit Online të ICMP-së (OIC) dhe Sistemin e Menaxhimit të Identifikimit të të Dhënave (IDMS);
- Sigurimi i **asistencës teknike** në lidhje me arkeologjinë dhe antropologjinë mjeko-ligjore;
- Sigurimi që **familjet e personave të zhdukur të informohen rregullisht** në lidhje me përparimin në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur.
- **Shpërndarja e informacioneve** në lidhje me procesin e kërkimit, rikuperimit dhe identifikimit për publikun, në konsultim me autoritetet shqiptare;
- **Mbledhja e të dhënave ante-mortem** (para vdekjes) për personat e zhdukur dhe mostrat gjenetike referuese nga anëtarët e familjes, në përputhje me politikatat e saj të mbrojtjes, së të dhënave.
- **Kryerja e testeve të ADN-së së mostrave post-mortem** (pas vdekjes) të pranuar nga institucioni përgjegjës i Shqipërisë, si dhe verifikimi i përputhshmërisë së profileve të ADN-së të marra prej tyre me mostrat e ADN-së të ofruara nga anëtarët e familjeve të të zhdukurve, në përputhje me procedurat standarde të veprimit.
- Komunikimi, në kohën e duhur, i **rezultateve të gjetjeve** Ministrisë së Brendshme, si institucioni shqiptar kompetent; etj.

Në vijim, marrëveshja i dedikon një hapësirë të veçantë përgjegjësive të autoriteteve shqiptare, pjesë e kësaj marrëveshje, duke përfshirë:⁸⁶

- **Sigurimi i çdo makinerie, pajisjeje dhe fuqie punëtore** të nevojshme për të gërmuar varreza dhe për të ndërmarrë ekzaminime;
- Mundësimi i **sigurisë në varreza** para dhe gjatë gërmimeve;
- Marrja e masave për të siguruar që **mbetjet e rikuperuara do të ruhen në mënyrën e duhur**;
- Marrja e **mostrave post-mortem** (pas vdekjes) në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit të ICMP-së dhe dorëzimi në laboratorët e ICMP-së;

85 Përmbledhur nga Neni 2 i Marrëveshjes.

86 Përmbledhur nga Neni 3 i Marrëveshjes.

- **Respektimi i legjislacionit shqiptar** në hetimin e rasteve të personave të zhdukur, duke përfshirë gërmimin e mbetjeve mortore dhe identifikimin e personave të gjetur;
- Kryerja e **identifikimeve përfundimtare**, duke përdorur raportet e ADN-së të ICMP-së dhe lëshimi i **certifikatave të vdekjes**;
- **Informimi i familjeve** të të zhdukurve në lidhje me identifikimet;
- Marrja e masave për të shënuar të dhënat përkatëse në **regjistrat e duhur**; etj.

Po ashtu, marrëveshja fokusohet në përcaktimin e statusit, privilegjeve dhe imunitetit të ICMP-së në Shqipëri. Kapitulli III i Marrëveshjes detajon të dhënat lidhur me zyrën e ICMP-së në Shqipëri, personalitetin juridik, fondet, drejtuesit, personelin, ekspertët, imunitetet e privilegjet, etj.

Në kuadër të këtij roli të rëndësishëm të ICMP-së në Shqipëri, në përputhje me parimet sa më lart, ky institucion ka publikuar në mars 2021 raportin me titull “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”.⁸⁷ Përveç pjesës përshkruese të legjislacionit dhe organeve të rëndësishme në zbatimin e legjislacionit, raporti i ICMP-së ndalet edhe në evidentimin e problemeve të hasura. Kështu, raporti ka gjetur se “nuk ka asnjë provë që Task Forca⁸⁸ të ketë kërkuar ndonjëherë një hetim të koordinuar me Zyrat e Prokurorit të Qarkut, të cilat janë të vetmet kompetente për të kryer një hetim dhe për të urdhëruar zhvarrosjen e varreve. Kompetencat e Task Forcës u transferuan në Institutin për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë në vitin 2014, dhe Task Forca pushoi punën e saj”.⁸⁹ Pavarësisht ekzistencës së legjislacionit bazë, duket se rritja e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike apo organizatave të tjera është thelbësor për përmirësimin e rezultateve. Po në të njëjtin përfundim është arritur edhe më vonë në raport, ku theksohet se “ISKK-ja nuk mban të dhëna të ndara për personat e zhdukur dhe nuk ka asnjë bashkëpunim zyrtar me I PPP-në për çështjen e personave të zhdukur, i cili ndodhet në të njëjtat ambiente”.⁹⁰

Raporti, po ashtu, fokusohet edhe te burimet e kufizuara financiare të disa prej autoriteteve që lidhen me informimin dhe rehabilitimin e familjarëve të viktimave të zhdukjes me forcë. Raporti shprehet se në Institutin për Integrimin dhe Rehabilitimin e ish-të Përndjekurve Politikë, “sektori për gjetjen e personave të zhdukur nga krimet komuniste nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të përbushur mandatin e tij origjinal për të rikuperuar dhe identifikuar mbetjet njerëzore”.⁹¹

Një tjetër problem i identifikuar në raport është edhe mungesa e modernizimit të arkivimit të informacionit. Sipas raportit, të gjitha të dhënat ruhen në kopje fizike,

87 Për më shumë informacion, vizito: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-ëb-152-6-alb-Ë-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>

88 Bëhet fjalë për Task Forcën për Zhvarrimin dhe Identifikimin e Mbetjeve Njerëzore të Viktimave Komuniste, të krijuar nga autoritetet shqiptare në vitin 2010.

89 Raporti i ICMP-së, “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”, 02.03.2021, faqe 7.

90 Ibid. faqe 9.

91 Raporti i ICMP-së, “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”, 02.03.2021, faqe 9.

dhe pajisjet në posedim të ISKK-së janë të vjetruara. ISKK-ja kërkoi ndihmë për digjitalizimin e të dhënave, në mënyrë që të dhënat të bëhen të disponueshme për publikun.⁹²

1. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë mbi zhdukjen me forcë

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë⁹³ trajton, direkt dhe indirekt, çështje që lidhen me zhdukjen me forcë. Së pari, në kuadër të parimeve të përgjithshme të parashtruara në pjesën e parë të këtij kodi, vlen të nënvizohet në lidhje me këtë studim detyrimi i legjislacionit penal për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë e tij.⁹⁴ Po ashtu, ky kod thekson se një nga parimet mbi të cilat mbështetet është ai i humanizmit.⁹⁵

Në vijim, Kodi Penal trajton më konkretisht (ndër të tjera) krimet që lidhen me zhdukjen me forcë. Kodi i klasifikon këto të fundit nën titullin e “Krimeve kundër njerëzimit”. Një qëndrim i tillë është në përputhje me parashikimet e Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (i cili u nënshkrua nga Republika e Shqipërisë më 18.07.1998⁹⁶ dhe parashikon zhdukjen me forcë si krim kundër njerëzimit, duke sanksionuar detyrimin e shteteve për të kryer hetime efektive lidhur me personat e zhdukur), si dhe me Nenin 5 të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë⁹⁷.

Lidhur me sa më sipër, Kodi Penal i RSH-së e trajton zhdukjen me forcë në seksionin e krimeve kundër njerëzimit dhe parashikon që:

*“Vrasjet, zhdukja me forcë, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore, të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, ose në mënyrë sistematike, kundër një grupi të popullsisë civile, për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”.*⁹⁸

Në vijim, Kodi Penal trajton në një nen më vete pikërisht veprën penale të **zhdukjes me forcë**, duke parashikuar që:

*“Zhdukja me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë apo nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë apo me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ndodhet ai, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas ligjit, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.*⁹⁹

92 Ibid. faqe 9.

93 Ligji Nr. Nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

94 Neni 1/b i Kodit Penal.

95 Neni 1/c i Kodit Penal.

96 Për më shumë informacion, shiko Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare: <https://www.icc-cpi.int/resource-library/documents/rs-eng.pdf>

97 siç është diskutuar më lart në këtë studim.

98 Neni 74 i Kodit Penal.

99 Paragrafi i parë i nenit 109/c të Kodit Penal.

Një nga çështjet më të rëndësishme që mbeten në fokus të diskutimeve lidhur me parashikimet e Kodit aktual Penal të Shqipërisë mbi zhdukjet me forcë, është **veprimi në kohë** i këtij kodi lidhur me zhdukjet gjatë periudhës së komunizmit. Ky kod ka hyrë në fuqi me miratimin e tij nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 27.01.1995, pra disa vite pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri. Vetë Kodi parashikon se askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale.¹⁰⁰ Për këtë arsye, për të kuptuar nëse parashikimet e tij mund të përdoren edhe në rastin e zhdukjeve të ndodhura gjatë periudhës së komunizmit, është e rëndësishme të përcaktohet zgjatja në kohë e kësaj veprë penale.

Duke iu referuar Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, Neni 17(1) i saj parashikon që veprimet që përbëjnë zhdukjen me forcë do të konsiderohen si një vepër e vazhdueshme për aq kohë sa autorët vazhdojnë të fshehin fatin dhe vendndodhjen e personave që janë zhdukur dhe këto fakte mbeten të pasqaruara. Rrjedhimisht, zhdukja me forcë trajtohet si një vepër penale e **vazhdueshme**, e cila nuk përfundon me humbjen e kontakteve të viktimës me familjarët, por zgjatet në kohë deri në momentin që faktet e zhdukjes sqarohen. Edhe kur mund të konkludohet se personi i zhdukur në të vërtetë iu nënshtrua një ekzekutimi arbitrar, për shembull përmes zbulimit të mbetjeve mortore dhe njohjes së sendeve personale, për sa kohë që nuk përcaktohet vendndodhja e atij personi, ose mbetjet nuk janë gjetur dhe identifikuar, situata është ajo e zhdukjes me forcë.¹⁰¹

Po ashtu, pavarësisht se veprat penale në përgjithësi i nënshtrohen rregullave të parashkrimit pas kalimit të një kohe të caktuar pas kryerjes së veprës penale,¹⁰² Kodi Penal nënvizon në një nen më vete faktin që **krimet kundër njerëzimit nuk i nënshtrohen parashkrimit të veprës penale**. Ashtu siç është përmendur në fillim të këtij nën-kapitulli, zhdukja me forcë është një vepër që bën pjesë në grupin e krimeve kundër njerëzimit. Rrjedhimisht, parashikimet e Nenit 66 të Kodit Penal lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale nuk aplikohen në këtë rast.

2. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë lidhur me zhdukjen me forcë

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë¹⁰³ nuk trajton në mënyrë të posaçme procedura specifike për veprën penale të zhdukjes me forcë, por parashtron parimet dhe rregullat kryesore nga të cilat do të udhëhiqen (ndër të tjera) edhe hetimet lidhur me këtë vepër penale. Kështu, në kuadrin e dispozitave të përgjithshme, ky kod nënvizon faktin që legjislacioni procedural penal ka për

100 Neni 3(1) i Kodit Penal.

101 Udhërrëfyes për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, faqe 15.

102 Për më shumë informacion lidhur me këto afate parashkrimi në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shiko Nenin 66 të KP-së.

103 Ligji Nr.7905, datë 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të **mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve**, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.¹⁰⁴ Në të njëjtën pjesë, KPrP-ja i jep rëndësi trajtimit të viktimave nga një vepër penale, duke theksuar që organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga KPrP-ja.¹⁰⁵

Analizimi i këtij kodi është i rëndësishëm, sidomos në kuadër të përcaktimit të procedurave që duhet të ndiqen nga organet kompetente të parashikuara nga ky kod për hetimet mbi personat e zhdukur me forcë gjatë periudhës së komunizmit. Së pari, për sa i përket **iniciativës për nisjen e hetimeve**, ky kod i atribuon një rol të rëndësishëm, në radhë të parë **prokurorit**. Ky i fundit ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe **kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm**, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në KPrP.¹⁰⁶ Po ashtu, një rol të rëndësishëm në këtë kuadër luan edhe **policia gjyqësore**, e cila **edhe me iniciativën e vet**, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, **të kryejë hetime** dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. Po ashtu, **gjykatat** luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e drejtësisë për viktimat e zhdukjes me forcë dhe/ose familjarët e tyre. Në përputhje me provat dhe informacionet e paraqitura nga organet e prokurorisë, gjykata vendos mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurve për veprën penale të zhdukjes me forcë.

3. Ligji “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”

Ligji “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”¹⁰⁷ është një ligj që fokusohet në rehabilitimin e viktimave (apo familjarëve të tyre) të dënimeve politike e të padrejta të komunizmit në Shqipëri. Qëndrimi i këtij ligji është në përputhje me qasjen e KEDNJ-së, sidomos parashikimet e Nenit 13 të Konventës lidhur me të drejtën për një zgjidhje efektive. Ky ligj synon dhënien e **dëmshpërblimit financiar** nga shteti shqiptar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe, si një angazhim i shtetit demokratik për dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë.¹⁰⁸ Në rastin e shpërblimit të familjarëve të viktimave, dëmshpërblimi konsiderohet si e drejtë jopasurore vetjake.¹⁰⁹

104 Neni 1 i KPrP-së.

105 Neni 9(1) i KPrP-së.

106 Neni 24(1) i KPrP-së.

107 Ligji Nr. 9831, datë 12.11.2007 (i ndryshuar).

108 Neni 2 i ligjit “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”.

109 Neni 6 dhe 7 i Ligjit “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”.

Kushtet për përfitimin e dëmshpërblimit në kuadër të këtij ligji renditen në Nenin 4 të tij. Ky i fundit parashikon që i dënuari (ose familjarët), për të përfituar dëmshpërblim duhet:

- të jetë dënuar me dënim kapital, heqje lirie, internim dhe dëbim apo të jetë izoluar në hetuesi ose në një institucion mjekësor psikiatrik, për shkak të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të një akti administrativ apo të urdhrave të hetuesisë, të dhëna gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991;
- heqja e lirisë, izolimi në hetuesi apo në një institucion mjekësor psikiatrik, me vendim gjyqësor të formës së prerë apo me urdhër të hetuesisë, të jetë për shkak të një veprë penale politike, siç përcaktohet në Nenin 5 të këtij ligji;
- të ketë kryer ose të ketë vuajtur dënim penal të padrejtë plotësisht ose pjesërisht;
- të kenë fituar pafajësinë, sipas ligjit nr. 7541, datë 30.09.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar;
- sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, të mos ketë kryer veprime të dëmshme, me pasoja për jetën e shtetasve të tjerë gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991.

Sa me sipër, ky ligj nuk aplikohet vetëm për personat e zhdukur me forcë gjatë komunizmit, por për **të gjithë të dënuarit politikë**. Në shumicën e rasteve, personat e zhdukur me forcë janë një pjesë e grupit më të madh të të dënuarve politikë. Ata zakonisht kanë qenë persona të dënuar me burgim, internim apo dëbim për arsye politike. Nga ana tjetër, për familjarët e personave të zhdukur me forcë, për të cilët nuk ka një vendim kapital, heqje lirie, internimi etj., mund të shtohen vështirësitë e provimit të zhdukjes nëpërmjet dokumentacionit, duke vështirësuar kështu zbatimin e të drejtës së tyre për dëmshpërblim, ose, në rastin më të keq, përjashtimin e aplikimit të ligjit mbi këto raste. Ky problem është njohur dhe raportuar edhe nga organe kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas “Udhërrëfyesit mbi të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit”, kompensimi raportohet se është i kufizuar vetëm te personat që posedojnë dokumente që vërtetojnë statusin e tyre (ose anëtarëve të familjes së tyre) si persona të persektuar politikë. Kjo lë shumë familje të viktimave të zhdukjes me forcë jashtë sferës së ligjit.¹¹⁰

Një parashikim i rëndësishëm i këtij ligji është përkufizimi i “rrethit të familjarëve” të legjitimuar për të kërkuar dëmshpërblim. Neni 8 i ligjit sanksionon se:

“Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë”.

¹¹⁰ Udhërrëfyes për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, faqe 18.

Dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji, nuk përjashton marrjen e masave të tjera, të njëkohshme ose të mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese apo krijimit të kushteve favorizuese, për riintegrimin shoqëror të tyre.¹¹¹ Edhe ky qëndrim, përputhet me parashikimet e Nenit 13 të KEDNJ-së për një zgjidhje efektive, si dhe me interpretimet nga ana e GJEDNJ-së të këtij neni në kuadër të zhdukjes me forcë. Në këto të fundit, gjykata ka qenë e kujdesshme të përmendë që përveç pagesës së dëmshpërblimit, kur është e përshtatshme, është i nevojshëm edhe një hetim i plotë dhe efektiv, i aftë të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës, si dhe të përfshijë qasjen e familjarëve në procedurën hetimore..

37

4. Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”¹¹² përcakton rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi **dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**. Këto të fundit përfshijnë dokumentet për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike,¹¹³ pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist.¹¹⁴ Ky ligj trajton një gamë më të gjerë çështjesh që nuk lidhen vetëm me zhdukjen me forcë të njerëzve gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, është i rëndësishëm në kuadër të këtij studimi sepse, së pari, jep për herë të parë përkufizimin e termit “person i zhdukur” në legjislacionin shqiptar:

*“Person i zhdukur, sipas fushës së veprimit të këtij ligji, është personi i arrestuar, i burgosur, i rrëmbyer ose të cilit i është hequr liria në çdo formë tjetër nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit”.*¹¹⁵

Po ashtu, ky ligj garanton respektimin e të drejtës për informacion, transparencë, përgatitje dokumentacioni dhe zbulimin e fatit të njerëzve të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri.

111 Neni 2 i Ligjit “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”.

112 Ligji Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Lidhja për ligjin: <https://qbz.gov.al/share/hOmphM9RTvidcsl3OuCluë>

113 Sipas përkufizimit të Ligjit nr. 7514, date 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar,

114 Neni 2 i Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

115 Neni 3(8) i Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Rregullat dhe procedurat që përcakton ky ligj lidhen me mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë; organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH); njohjen e personave me të dhënat e ruajtura nga ish-Sigurimi i Shtetit për ta; vënien në dispozicion të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të informacioneve të domosdoshme për qëllimet e ligjit, si dhe përcakton detyrimet e autoriteteve publike dhe arkivave për të vënë në dispozicion dokumentet e disponuara prej tyre.¹¹⁶ Ligji i kushton një rëndësi të veçantë rregullimit të funksionimit dhe organizimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), por ky i fundit do të trajtohet në një pjesë të veçantë në këtë studim.

Sipas këtij ligji, **çdo person** ka të drejtë të kërkojë nga AIDSSH-ja që të informohet nëse në dokumentet e administruara ka informacione për personin e tij, si dhe t'i marrë këto informacione, kur ka të tilla. Në varësi të kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së evidentimit të dokumentacionit, për çdo rast, Autoriteti përgjigjet brenda një afati të arsyeshëm.¹¹⁷ Rregulla të hollësishtme mbi këto afate parashikohen në rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit. Kështu, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar duke përfshirë edhe vendimmarrjen e Autoritetit, kryhet brenda afatit kohor prej 30 (tridhjetë) ditëve. Për shqyrtimin e kërkesave individuale, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar duke përfshirë edhe vendimmarrjen e Autoritetit, të kryhet brenda afatit kohor prej 6 (gjashtë) muaj kalendarikë. Për shqyrtimin e kërkesave nga studiues/media, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar duke përfshirë edhe vendimmarrjen e Autoritetit, të kryhet brenda afatit kohor prej 6 (gjashtë) muaj kalendarikë.¹¹⁸

Garantimi i së drejtës për informim është një nga parimet bazë për zbatimin e këtij ligji. Ai parashikohet në Nenin 20 të ligjit dhe lidhet me të drejtën e kërkuesit për t'u njohur me dokumentet kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose dublikatave të tyre. Megjithatë, Autoriteti mund ta kufizojë pjesërisht ose plotësisht garantimin e së drejtës për informim, kur të dhënat përbëjnë kërcënim real për sigurinë kombëtare. Në rastet kur dokumentet ose dublikatat, përveç informacioneve personale mbi kërkuesin, përmbajnë edhe të dhëna për të prekur të tjerë apo palë të treta, shqyrtimi i dokumenteve origjinale garantohet vetëm kur kjo miratohet nga të prekurit e tjerë apo palët e treta; është e pamundur ndarja e të dhënave mbi të prekurit e tjerë apo palët e treta; ose është e mundur vetëm me përpjekje të pajustificuara dhe nuk ka arsye për të prezumuar se të prekurit e tjerë apo palët e treta kanë interes të ligjshëm për mbajtjen e këtyre informacioneve të fshehta.

116 Neni 1 i Ligjit. "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

117 Neni 5 i Ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

118 Neni 38 i Rregullores mbi Organizimin dhe Funksionimin e AIDSSH-së.

Ligji trajton në mënyrë **specifike të drejtat për informim të familjarëve të të vdekurve apo të zhdukurve** në Nenet 22 dhe 22/1 të tij. Këta të fundit përbëjnë dhe nenet më të rëndësishëm në kuadër të këtij studimi. E drejta për të kërkuar informacion mbi ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për personat e vdekur dhe të shpallur të zhdukur, si dhe për shqyrtimin e dokumenteve u njihet edhe të afërmve të tyre, sipas kësaj radhe përparësie:

- a. Bashkëshortëve;
- b. Fëmijëve;
- c. Fëmijëve të fëmijëve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- ç. Prindërve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- d. Vëllezërve dhe motrave, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- dh. Fëmijëve të vëllezërve dhe motrave, kur personat e radhëve të mësipërme kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur.

Të afërmve u vihet në dispozicion informacioni me kërkesë dhe duke treguar lidhjen familjare. Synimi është ruajtja e të drejtave të personalitetit të të vdekurve apo të zhdukurve, në veçanti për sqarimin e akuzës së bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit; si dhe për të qartësuar fatin e të vdekurve apo të të zhdukurve.¹¹⁹

Ligji i kushton rëndësi edhe **bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve**, si dhe **masave për ruajtjen e vendvarrimeve**. Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime.¹²⁰

1. Institucionet shqiptare të cilat luajnë rol në trajtimin e çështjeve të zhdukjes me forcë gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri

a. Institucione me kompetenca të përgjithshme

Zhdukja me forcë është një vepër penale e cila konsiderohet që kryhet në vazhdimësi deri në zbardhjen e plotë të informacionit lidhur me personin e zhdukur. Rrjedhimisht, të gjitha autoritetet publike të cilat trajtojnë veprat penale në përgjithësi, luajnë rol të rëndësishëm edhe në çështjet e zhdukjes me forcë. Vetë Ligji nr. 83/2018

119 Neni 22 i Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

120 Neni 22(1) i Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

“Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”¹²¹ parashikon se institucionet e tjera në zbatim të Marrëveshjes nënkuptojnë:

- Autoritetet **kombëtare, qendrore dhe vendore** dhe autoritete të tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Instituti për Mjekësinë Ligjore;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Drejtësisë; etj.¹²²

i. Prokuroritë

Nga sa më sipër, një rol të veçantë luajnë **prokuroritë**, të cilat, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ushtrojnë ndjekjen penale dhe përfaqësojnë akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejtojnë dhe kontrollojnë hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, kryejnë vetë çdo veprim hetimor që e çmojnë të nevojshëm, etj. Po ashtu, përveçse gjykatat, edhe prokuroritë mund të urdhërojnë zhvarrimin, duke njoftuar një pjesëtar të familjes së të vdekurit për të marrë pjesë, me përjashtim të rasteve kur kjo pjesëmarrje mund të dëmtojë qëllimin e këqyrjes.¹²³ Prokurori mund të bëjë kërkesa për ekspertime pranë Institutit për Mjekësinë Ligjore.¹²⁴ Gjithashtu, pasi merr pëlqimin e të pandehurit ose personave të tjerë, prokurori mund të kërkojë marrjen e kampionëve biologjikë, me qëllim përcaktimin e profilit të ADN-së. I njëjti parashikim zbatohet edhe për kryerjen e procedurës mjekësore.¹²⁵

Megjithatë, vihet re se angazhimi i prokurorisë në çështjet e gjetjes së trupave të viktimave të zhdukjes me forcë jo gjithmonë ka gëzuar vëmendje të posaçme. Raporti i ICMP-së i vitit 2021 sjell në vëmendje se “*deri më tani është urdhëruar vetëm një gërmim nga zyra e prokuroritë përgjegjës. Prokurori i rrethit Sarandë urdhëroi një zhvarrosje bazuar në informacionet e dhëna nga një anëtar i familjes në lidhje me ish-kampin e burgut në fshatin Borsh të rrethit të Sarandës. Mbetjet njerëzore të një individi, që besohet të jetë një prej të zhdukurve nga epoka komuniste, u zhvarrosën në tetor 2019*”.¹²⁶ Sipas po të njëjtit raport, mungesa e veprimeve mbështetëse nga ana e prokurorive lidhur me këtë çështje lidhet me arsye si: zvogëlimi i numrit të

121 Për më shumë informacion rreth Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), lexo në kreun me të njëjtin titull në këtë studim.

122 Neni 2 i Ligjit Nr. 83/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

123 Neni 200 i KPrP-së.

124 Neni 1(9) i Vendimit Nr. 680, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore”.

125 Neni 200/a i KPrP-së.

126 Raporti i ICMP-së “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”, 02.03.2021, faqe 12.

prokurorëve për shkak të shkarkimeve nga procesi i vetingut, mungesa e burimeve financiare për të mbuluar kostot që do të lindin nga angazhimi i ekspertëve teknikë të Institutit të Mjekësisë Ligjore,¹²⁷ etj.

ii. Gjykatat

Organet me rëndësi të veçantë në këtë kuadër janë po ashtu **gjykatat**, si organet që realizojnë dhënien e drejtësisë. Gjykatat penale në këtë rast luajnë një rol kyç, duke vendosur lidhur me fajësinë apo jo të autorëve të këtyre veprave,¹²⁸ duke urdhëruar zhvarrimin e mbetjeve të trupave,¹²⁹ duke kërkuar ekspertime pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore,¹³⁰ etj. Megjithatë, edhe gjykatat jo penale janë të përfshira në procesin e garantimit të të drejtave për viktimat e zhdukjes me forcë dhe/ose familjarëve të tyre. Legjislacioni i posaçëm për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit parashikon në disa nene mundësinë e ankimit të vendimeve të autoritetit në Gjykatën Administrative.¹³¹

iii. Instituti i Mjekësisë Ligjore

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) është një organ me interes të veçantë për këtë studim. Në përputhje me Vendimin Nr. 680, datë 02.09.2020, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore", përcaktohen kompetencat e këtij institucioni. Është ky organ publik i cili realizon ekspertimet e kërkuara nga gjykatat apo prokuroritë. IML-ja ka një rol të rëndësishëm në procesin e identifikimit të eshtrave të të zhdukurve, pasi ata kanë detyrën e marrjes së mostrave dhe kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore, për të dalë më pas në një konkluzion të saktë të kohës, kushteve/rrethanave të vrasjes së viktimës, si dhe të dhënave të tjera si: moshë, gjinia, përmasat trupore, apo dhe identitetit të saktë të viktimës në rast të kryerjes së analizës së ADN-së.¹³² Megjithatë, vendimi i mësipërm është hartuar në bazë parimesh dhe nuk përcakton detaje lidhur me çështjet teknike të realizimit të detyrave të IML-së. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore¹³³ detajon pak më shumë specifikat teknike të punës së IML-së lidhur me procedurën e zhvarrimeve, duke përcaktuar një afat limit për përfundimin e akteve mjeko-ligjore mbi ekzaminimin e kufomave të zhvarrosura ose eshtrave skeletike deri në tri javë.¹³⁴ Megjithatë, edhe kjo Rregullore nuk parashikon detaje specifike lidhur me mënyrën e trajtimit të rasteve të gjetjes së trupave që dyshohet të jenë viktimat e zhdukjes me forcë.

127 Për më shumë informacion, shiko Raporti i ICMP-së "Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave", 02.03.2021, faqe 12.

128 Udhërrëfyes për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, faqe 7.

129 Neni 200 i KPrP-së.

130 Neni 1(9) i Vendimit Nr. 680, datë 02.09.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore".

131 Për shembull, Nenet 5, 40, 41 të Ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

132 Udhërrëfyes për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, faqe 8.

133 Miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 6745, datë 04.11.2003, miratuar ndryshimet me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 7194/1, datë 24.01.2006.

134 Neni 59 i Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Sipas raportit të ICMP-së të vitit 2021, IML-ja nuk punëson arkeologë mjekoligjorë që kërkohen për gërmime dhe rikuperim të mbetjeve njerëzore nga varret masive,¹³⁵ çka mund të dëmtonte të dhënat dhe informacionet që mund të merreshin në vendngjarje nga këta ekspertë. Po ky raport, në konkluzionet e tij, nënvizon se IML-ja nuk ka hapësira të mjaftueshme për ruajtjen dhe ekzaminimin e mbetjeve njerëzore të gjetura përmes hetimeve për rastet e personave të zhdukur.¹³⁶

b. Institucione me kompetenca të posaçme

i. Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. AIDSSH-ja është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Funkcionet e tij lidhen me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to. AIDSSH-ja e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Ai ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta.¹³⁷ Me ndryshimet e fundit në ligjin e tij bazë “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH-së”, AIDSSH-ja ka marrë një rol të ri, koordinues, me të gjitha institucionet e tjera shtetërore për procesin e gjetjes, identifikimit dhe rekuperimit të trupave të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit.¹³⁸

Ky Autoritet ka disa **përgjegjësi të rëndësishme**, të cilat lidhen ngushtësisht me garantimin e të drejtës për informim dhe mbledhje provash për familjarët e viktimave të zhdukjes me forcë. Këto përgjegjësi përfshijnë: grumbullimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji; vlerësimin, renditjen, evidentimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, sipas rregullave dhe parimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat; bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të ligjit; **dhënien e informacioneve e të njoftimeve** mbi dokumentet, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimit e tyre për kërkuesit; mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet **garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve** dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve; **informimin e individëve**, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, në përputhje me ligjin.¹³⁹

135 Raporti i ICMP-së “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”, 02.03.2021, faqe 11.

136 Ibid. faqe 15.

137 Përmbledhur nga Neni 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

138 Udhërrëfyes për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, faqe 8.

139 Neni 10 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Ligji i dedikon vëmendje të veçantë përcaktimit të rregullave mbi mbledhjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kthimit, arkivimit të tyre, etj. Megjithatë, për qëllime të këtij studimi, roli i këtij Autoriteti do të analizohet nën fokusin e të drejtës së subjekteve për informim dhe vënies në dispozicion të dokumenteve. Kësaj çështjeje i kushtohet një kapitull i veçantë dhe i detajuar në ligj. Autoriteti garanton të drejtën e subjekteve për informim. Kërkuesit i njihet e drejta për t'u njohur me dokumentet kur ai ka cilësinë e:

- të prekurit;
- palës së tretë;
- bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit.¹⁴⁰

Për garantimin e kësaj të drejte, personat e interesuar paraqesin **kërkesë me shkrim dhe dokumentin e identifikimit** pranë Autoritetit për t'u informuar për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Kur kërkuesi çmon se kërkesa e tij duhet të trajtohet me përparësi, ai argumenton nevojën dhe urgjencën në kërkesë. Autoriteti pranon se ndodhet përpara nevojës urgjente, kur informacioni i kërkuar nevojitet për qëllime rehabilitimi, dëmshpërblimi, shmangieje të cenimit të jetës private apo të demit moral ose vërtetimin e faktit të mosbashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit. Autoriteti i jep informacionet me shkrim, përveçse kur është e nevojshme një formë tjetër e dhënies së informacionit.¹⁴¹

Nenet 22 dhe 22/1 të këtij ligji i kushtohen në mënyrë të veçantë të drejtës për informim të të afërmeve të të vdekurve apo të zhdukurve. E drejta për të kërkuar informacion mbi ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për personat e vdekur dhe të shpallur të zhdukur, si dhe për shqyrtimin e dokumenteve u njihet edhe të afërmeve të tyre, sipas kësaj radhe përparësie:

- a. Bashkëshortëve;
- b. Fëmijëve;
- c. Fëmijëve të fëmijëve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- ç. Prindërve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- d. Vëllezërve dhe motrave, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;
- dh. Fëmijëve të vëllezërve dhe motrave, kur personat e radhëve të mësipërme kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur.¹⁴²

140 Neni 20 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

141 Neni 19 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

142 Neni 22 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Të afërmve u vihet në dispozicion informacioni me kërkesë dhe duke treguar lidhjen familjare. Synimi është ruajtja e të drejtave të personalitetit të të vdekurve apo të zhdukurve, në veçanti për sqarimin e akuzës së bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit, si dhe për të qartësuar fatin e të vdekurve apo të të zhdukurve.

Në kuadër të bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuuarve, si dhe masave për ruajtjen e vendvarrimeve, AIDSSH-ja bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo që do të identifikohen si vendvarrime.¹⁴³ Rregulla më të hollësishme lidhur me këtë bashkëpunim parashikohet të detajohen në marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe ndërmjet institucioneve, ndërsa hollësi të tjera të këtyre parimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Deri tani ka pasur pak përparim në këtë drejtim. Aktet nënligjore në këtë drejtim nuk kanë qenë të plota, dhe ende ka paqartësi lidhur me zbatimin e parimeve të Nenit 22/1 në praktikë. Edhe ICMP-ja në raportin e tij të vitit 2021 për Shqipërinë, arrin në përfundimin se “*në mënyrë që Autoriteti të përmbushë rolin e tij në përputhje me ndryshimet në Ligjin 45/2015, Zyra e Kryeministrit duhet të hartojë pa vonesë legjislacionin dytësor të nevojshëm për funksionimin efektiv të departamentit të ri për personat e zhdukur brenda Autoritetit*”¹⁴⁴

Megjithatë, ligji parashikon edhe kufizime lidhur me të drejtën për qasje në këto dokumente. Për shembull, përdorimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale lejohet nga Autoriteti vetëm për qëllimet e parashikuara në ligj. Disa nga qëllimet e renditura, që lidhen me objektin e këtij studimi, janë:

- rehabilitimi i të prekurve, të vdekurve apo të zhdukurve;
- dëmshpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- mbrojtja e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare;
- qartësimi i fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve; etj.¹⁴⁵

Në rast refuzimi të Autoritetit për t’iu përgjigjur një kërkesë për informacion, kërkuesit kanë të drejtë të paraqesin ankim në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative.¹⁴⁶

143 Neni 22/1 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

144 Raporti i ICMP-së “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”, 02.03.2021, faqe 16.

145 Neni 28 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

146 Neni 41 i Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

ii. Instituti i Integritit të të Përndjekurve

Instituti i Integritit të të Përndjekurve (IIP), është institucion shtetëror në varësi të ministrisë kompetente për mirëqenien sociale¹⁴⁷ dhe ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist. Organizimi dhe funksionimi i IIP-së rregullohet nga ligji “Për Institutin e Integritit të të Përndjekurve”.¹⁴⁸ Ky i fundit përcakton që IIP-ja përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me të përndjekurit në bashkëpunim me shoqatat e të përndjekurve, duke lidhur për këtë qëllim marrëveshjet përkatëse.¹⁴⁹

Ligji kryesor ku e bazon veprimtarinë IIP-ja është Ligji “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”.¹⁵⁰ Ashtu siç është diskutuar në nënkapitullin kushtuar këtij ligji, ai aplikohet për të gjithë të dënuarit politikë, jo vetëm për familjarët e personave të zhdukur me forcë. Këta të fundit zakonisht kanë qenë persona të dënuar me burgim, internim apo dëbim për arsye politike. Nga ana tjetër, për familjarët e personave të zhdukur me forcë, për të cilët nuk ka një vendim kapital, heqje lirie, internimi etj., mund të shtohen vështirësitë e provimit të zhdukjes nëpërmjet dokumentacionit, duke vështirësuar kështu zbatimin e të drejtës së tyre për dëmshpërblim.

IPP është Instituti i Integritit të të Përndjekurve dhe një nga organet bashkëpunuese me ICMP-në për gjetjen e personave të zhdukur me forcë gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

iii. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit është institucion publik, qendror, i pavarur dhe gëzon statusin e personit juridik. Ai është krijuar nga ligji “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.¹⁵¹ Ky ligj përcakton (ndër të tjera) tërësinë e kushteve për grumbullimin, administrimin e ruajtjen, në arkivin e Institutit, të dokumenteve e të materialeve që dëshmojnë krimet e komunizmit në Shqipëri.¹⁵²

Pavarësisht se ky Institut nuk lidhet vetëm me viktimat e zhdukjes me forcë gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, një numër i rëndësishëm funksionesh të tij shërbejnë në ndihmë të viktimave të zhdukjes me forcë apo familjarëve të tyre. Disa nga detyrat e këtij Instituti, që lidhen me kontekstin e këtij studimi, janë:

- Analizimi, studimi dhe dokumentimi i krimeve të kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;
- Identifikimi i akteve ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore

147 Aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

148 Ligji Nr. 8246, datë 1.10.1997, “Për Institutin e Integritit të të Përndjekurve”.

149 Neni 2 i Ligjit Nr. 8246, datë 1.10.1997, “Për Institutin e Integritit të të Përndjekurve”.

150 Trajtuar në një nënkapitull të veçantë në këtë studim.

151 Ligji Nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

152 Neni 2 i Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;

- Studimi dhe vlerësimi i ndërtimit, organizimit institucional dhe veprimtarisë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- Studimi dhe vlerësimi i veprimtarisë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- Analizimi i shkaqeve dhe rrugëve të vendosjes së regjimit komunist, dokumenteve që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë apo të huaj që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre që bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- Grumbullimi i të dhënave, dokumenteve dhe dëshmime për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe strukturave të Sigurimit të Shtetit, formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- Përpunimi, në formë elektronike, i gjithë dokumentacionit për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- Bashkëpunimi me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit dhe përvojës lidhur me objektin e punës së institutit; etj.

Në kuadër të detyrave sa më sipër, ky institut ka potencialin të luajë një rol të rëndësishëm në pajisjen me dokumentacion dhe të dhëna të familjarëve të personave të zhdukur me forcë. Po ashtu, bashkëpunimi i këtij instituti me organet e tjera të mësipërme (të posaçme apo jo) që kanë si funksion zbulimin e fatit të të zhdukurve dhe kompensimin e familjarëve, është i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të këtyre procedurave.

III. Përfundime

Në aspektin ndërkombëtar, kuadri ligjor i trajtimit të problemeve që lidhen me viktimat e zhdukjes me forcë është i plotë dhe kryesisht pa përplasje apo kundërshti midis instrumenteve të ndryshëm ndërkombëtarë dedikuar atyre. Ndër të tjera, GJEDNJ-ja ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në interpretimet e Neneve 2, 3, 5 dhe 13 të KEDNJ-së në kuadër të zhdukjes së detyruar, duke përcaktuar parime të rëndësishme si:

- Prezumimi i shkeljes se Nenit 2 të KEDNJ-së në rastin kur viktimat është parë në rrethana kërcënuese për jetën dhe shteti nuk mund të ofrojë informacion për vendndodhjen e saj;
- Aplikimi i shkeljes së Nenit 3 të KEDNJ-së jo vetëm në mbrojtje të viktimave të drejtpërdrejta të zhdukjes me forcë, por edhe në mbrojtje të familjarëve të tyre;
- Aplikimi i Nenit 5 të KEDNJ-së në çdo rast që lidhet me zhdukjen me forcë;
- Aplikimi i Nenit 13 të KEDNJ-së në kuadër të një kompensimi të drejtë lidhet jo vetëm me kompensimin në para, por edhe me detyrimin e shtetit palë për të ofruar informacionin e nevojshëm për familjarët e viktimave të zhdukjes me forcë.

Në vijim, Deklarata e OKB-së mbi Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, ndonëse nuk është një dokument me forcë shtrënguese ligjore, përcakton një përkufizim të plotë të “zhdukjes me forcë”. Po ashtu, kjo Deklaratë përcakton një përgjegjësi të trefishtë për shtetet/autoritetet të cilat përfshihen në akte të zhdukjes së detyruar: përgjegjësi penale, përgjegjësi civile dhe përgjegjësi ndërkombëtare. Në frymën e Deklaratës së mësipërme, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë reflekton të njëjtat parime, duke hedhur edhe hapa të rinj në vazhdim të rrugës së nisur nga Deklarata dhe duke qenë tashmë e detyrueshme për t’u respektuar nga palët nënshkruese të saj. Të dy këta instrumente parashikojnë që krimi i zhdukjes me forcë bën pjesë te krimet kundër njerëzimit dhe ndalimi për kryerjen e këtij krimi ka një natyrë absolute.

Organet ndërkombëtare në zbatim të instrumenteve ndërkombëtarë janë të shumtë, por në veçanti duhet të përmendet ICMP-ja, që ka si objekt sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet qeverive dhe të tjerëve për gjetjen e personave të zhdukur nga konfliktet, abuzimet e të drejtave të njeriut, fatkeqësitë, krimi i organizuar,

migrimi i parregullt dhe shkaqe të tjera.

Në aspektin kombëtar, Shqipëria, si një vend që ka përjetuar një regjim komunist rreth 45-vjeçar, e ka të nevojshëm një rregullim të hollësishëm, efektiv dhe të shpejtë për zbulimin e fatit të viktimave të zhdukjes me forcë, informimin e kompensimin e familjarëve të viktimave, etj. Një përkufizim zyrtar i termit “zhdukje e detyruar” është realizuar vonë (duke marrë parasysh momentin e rënies së komunizmit në Shqipëri dhe historinë e dhimbshme të zhdukjeve me forcë që janë praktikuar gjatë komunizmit) në Ligjin Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se nuk parashikon në mënyrë të shprehur termin “zhdukje me forcë” apo “person i zhdukur”, parashikon një sërë parimesh të analizuara në këtë punim, të cilat dënojnë akte si zhdukja me forcë. Shqipëria është nënshkruese e konventave ndërkombëtare të përmendura më lart dhe është e detyruar të respektojë parashikimet e tyre. Përveç këtyre konventave, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë ka nënshkruar po ashtu një marrëveshje bashkëpunimi me ICMP-në. Sipas kësaj marrëveshjeje, Shqipëria ka detyrimin për mbrojtjen e interesave të familjarëve të viktimave të zhdukjes me forcë. Po ashtu marrëveshja detajon kompetencat dhe bashkëpunimin e zyrës së ICMP-së në Shqipëri me shtetin shqiptar. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, ICMP-ja në vitin 2021 ka publikuar një raport lidhur me vlerësimin e nevojave të Shqipërisë për personat e zhdukur gjatë komunizmit, ku ka konstatuar edhe disa nga problematikat me kryesore, si mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shqiptare për zhvarrosjen, arkivimin apo hetimin e koordinuar të zhdukjeve me forcë që kanë ndodhur gjatë komunizmit, burimet e kufizuara financiare të disa prej autoriteteve që lidhen me informimin dhe rehabilitimin e familjarëve të viktimave të zhdukjes me forcë, mungesën e modernizimit të arkivimit të informacionit, etj.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë kategorizon zhdukjen me forcë në seksionin e krimeve kundër njerëzimit. Pavarësisht se ky kod ka hyrë në fuqi pas rënies së komunizmit, është e rëndësishme të theksohet se, në përputhje me qëndrimet e konventave ndërkombëtare, zhdukja me forcë është një vepër penale e vazhdueshme, e cila nuk përfundon me humbjen e kontakteve të viktimës me familjarët, por zgjatet në kohë deri në momentin që faktet e zhdukjes sqarohen. Për këtë arsye, Kodi aktual Penal konsiderohet i aplikueshëm edhe për zhdukjet e ndodhura në periudhën e komunizmit në Shqipëri. Nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë parashikon kryesisht prokurorinë si institucioni i iniciativës për nisjen e hetimeve (përfshirë edhe në rastin e krimeve si zhdukja me forcë), por gjithashtu një rol të rëndësishëm sipas këtij kodi luajnë edhe Policia Gjyqësore dhe Gjykatat.

Në këtë studim janë analizuar një numër ligjesh që luajnë rol të rëndësishëm në trajtimin e viktimave të zhdukjes me forcë apo familjarëve të tyre. Megjithatë, një pjesë prej tyre hasin edhe sfida e probleme. Për shembull, Ligji “Për Dëmshtëpërlimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist” është një ligj që fokusohet te rehabilitimi i viktimave (apo familjarëve të tyre) të dënimeve politike e të padrejta të komunizmit në Shqipëri. Megjithatë, në rastin e familjarëve të viktimave të zhdukjes me forcë (jo të dënuarve politikë në përgjithësi), hasen vështirësi shtesë, të cilat janë

raportuar nga organe kombëtare dhe ndërkombëtare. Kështu, raportimet tregojnë se kompensimi është i kufizuar vetëm te personat që posedojnë dokumente që vërtetojnë statusin e tyre (ose anëtarëve të familjes së tyre) si persona të persekutuuar politikë, duke lënë shumë familje të viktimave të zhdukjes me forcë jashtë sferës së këtij ligji. Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për rikuperimin e trupave të zhdukurve dhe të ekzekutuarve, si dhe masave për ruajtjen e vendvarrimeve. Megjithatë, sipas raportimit të ICMP-së të vitit 2021, bashkëpunimi nuk ka qenë në nivelin e duhur.

Studimi, së fundi, fokusohet edhe tek institucionet kryesore shqiptare që trajtojnë pasojat e krimit të zhdukjes me forcë gjate periudhës komuniste. Disa nga problemet që vihen re apo që janë raportuar lidhur me këto institucione mund të përmblihen si më poshtë: Sipas raportit të ICMP-së të vitit 2021, angazhimi i prokurorisë në çështjet e gjetjes së trupave të viktimave të zhdukjes me forcë jo gjithmonë ka gëzuar vëmendje të posaçme; Rregullorja e Përgjithshme e Institutit të Mjekësisë Ligjore nuk parashikon detaje specifike lidhur me mënyrën e trajtimit të rasteve të gjetjes së trupave që dyshohet të jenë viktima të zhdukjes me forcë; Instituti i Mjekësisë Ligjore nuk punëson arkeologë mjekoligjorë që kërkohen për gërmime dhe rikuperim të mbetjeve njerëzore nga varret masive. Po ashtu, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), një organ i posaçëm për trajtimin e problemeve të zhdukjes së detyruar gjatë komunizmit në Shqipëri, karakterizohet nga mungesa e legjislacionit dytësor, i cili do të mundësonte funksionimin efektiv të departamentit të ri për personat e zhdukur.

IV. Bibliografi

Marrëveshje ndërkombëtare, legjislacioni dhe e drejta ndërkombëtare

- The Universal Declaration on Human Rights
- The European Convention on Human Rights
- United Nations Declaration on the Protection of All Persons from Enforced Disappearances, December 18, 1992
- The International Convention for the Protection of all Persons against Enforced Disappearance (ICPPED)
- The Statute of the International Criminal Court: <https://www.icc-cpi.int/resource-library/documents/rs-eng.pdf>
- United Kingdom Guardianship (Missing Persons) Act, <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2017/27/enacted>
- The Council of Europe Parliamentary Assembly's Resolution 1481 (2006)
- Ligji Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"
- Ligji Nr. Nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 7905, datë 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
- Ligji "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"
- Ligji Nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist" (i ndryshuar)
- Ligji nr. 7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë"
- Ligji Nr. 83/2018, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)"
- Ligji Nr. 8246, datë 1.10.1997, "Për institutin e integritetit të të përndjekurve"
- Ligji Nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri"
- Rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së
- Vendimi Nr. 680, datë 02.09.2020, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore"

Libra, raporte dhe artikuj

- J. Sisson, Anne-Marie La Rosa and Monique Crettol, “The Missing and Transitional Justice: The Right to Know and the Fight against Impunity”, International Review of the Red Cross, Vol. 88, No. 862, 2006
- Kyriakou, Nikolas, An affront to the conscience of humanity: Enforced disappearance in international human rights law, European University Institute, Florence, June 2012
- Guiding principles. Model law on the missing, International Committee of the Red Cross (ICRC), 2009
- ‘Standards and public policies for an effective investigation of enforced disappearances’, The University of Texas School of Law, 02.01.2019
- Albania, Missing persons from the communist era: a needs assessment, ICMP Report, Sarajevo, 2 March 2021 ICMP.GR.WB.152.6.W.doc
- Enforced or Involuntary Disappearances, Fact Sheet No. 6/Rev. 3, Office of the United Nations, High Commissioner for Human Rights
- Missing persons and victims of enforced disappearance in Europe, Council of Europe Commissioner for Human Rights, March 2016
- United Nation’s (UN) High Commissioner for Human Rights’ Fact Sheet No. 6, rev 3, Enforced or Involuntary Disappearances, July 2009
- Udhërrëfyes për të drejtat e familjareve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit
- Raporti i ICMP-së “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i nevojave”, 02.03.2021
- Statusi i Personave të Zhdukur gjatë Diktaturës Komuniste, Shqipëria Tranzicionale, Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, 2021

Vendime të gjykatave

- European Court of Human Rights, *Cyprus v. Turkey*, judgment of 10 May 2001
- European Court of Human Rights, *Šilih v. Slovenia*, judgment of 9 April 2009
- European Court of Human Rights, *Zaurbekova and Zaurbekova v. Russia*, judgment of 22 January
- European Court of Human Rights, *Janowiec and Others v. Russia*, judgment of 16 April 2012
- European Court of Human Rights, *Kurt v. Turkey*, judgment of 1998
- European Court of Human Rights, *Mujkanovic and others v Bosnia and Herzegovina*, Application No. 47063/08
- European Court of Human Rights, *Tanis and others v. Turkey*, Application No. 65899/0
- European Court of Human Rights, *Ipek v. Turkey*, Application No. 25760/94

Faqe interneti

- ICMP official Website: <https://www.icmp.int>
- CED official Website: <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/ced/pages/cedindex.aspx>
- WGEID official Website: <https://ijrcenter.org/un-special-procedures/working-group-on-enforced-or-involuntary-disappearances/>
- ICRC official Website: <https://www.icrc.org/en/mandate-and-mission>
- AIDSSH official Website: <http://autoritetidosjeve.gov.al/>
- ISKK official Website: <http://www.iskk.gov.al/>

Një analizë sociologjike mbi përndjekjen politike dhe zhdukjen e njerëzve nga regjimi komunist

Teuta Starova

53

ZHDUKJA E NJERËZVE GJATË REGJIMIT
KOMUNIST - PËRMBLEDHJE PUNIMESH

Hyrje

Në shumë studime të autorëve shqiptarë dhe të huaj, Shqipëria është cilësuar si një vend ish-komunist, i cili ka pasur regjimin më të egër diktatorial, por edhe pas tridhjetë viteve tranzicion, ka mbetur ende shumë për të bërë në fushën e vendosjes së drejtësisë kundrejt viktimave të asaj diktature komuniste apo në fushën e drejtësisë tranzitore.

Objektiv kryesor mbetet ende hulumtimi i plotë i shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë periudhës komuniste, si një ndër mekanizmat kryesorë të drejtësisë tranzitore në Shqipëri. Ky studim përfaqëson një përpjekje për të analizuar dhe paraqitur informacion, si dhe për të hulumtuar dhe arsyetuar rreth fakteve të përndjekjeve të kryera në Shqipëri nga regjimi komunist.

Vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të çështjes së njerëzve të zhdukur nga regjimi komunist dhe përndjekjes politike të grave, përsirë edhe ato gra të cilat, ndonëse nuk u përndoqën, pësuan mbi veten dhe familjet e tyre egërsitë e përndjekjes politike të të afërmeve nga regjimi komunist. Mungesa e informacionit të nevojshëm për të bërë një analizë sa më të plotë ka qenë një prej vështirësive të mëdha të këtij studimi. Megjithatë, me aq sa ka qenë e mundur, është bërë një përpjekje për të analizuar nga një perspektivë gjinore rastet e studiuara të grave të përndjekura të Qarkut të Tiranës.

Synimi themelor i studimit është të kalohet përtej hulumtimit konkret të fakteve, duke nxjerrë edhe disa përfundime në lidhje me shkaqet e mosrealizimit të plotë të drejtësisë tranzitore në Shqipëri dhe rolin e faktorit politik.

Materiali i studimit është mbështetur kryesisht në dosje të arkivave mbi njerëzit e përndjekur, dëshmi të përfaqësuesve të familjeve të përndjekura, botime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), libra me kujtime, burime të internetit dhe burime të tjera dytësore.

I gjithë punimi udhëhiqet dhe mbështetet në themelin teorik dhe përvojën praktike të fushës krahasimisht të re studimore, rreth tridhjetëvjeçare, të drejtësisë tranzitore. Kornizën metodologjike të këtij punimi e përbën kërkimi cilësor nëpërmjet studimeve të veçanta në fushën e drejtësisë tranzitore.

I. Përpyjekje fillestare për veprimin e drejtësisë tranzitore në Shqipërinë paskomuniste

Përvoja historike dhe jetësore ka treguar se për të gjitha shoqëritë pasdiktatoriale, opinioni publik është ballafaquar me pyetje të rëndësishme në lidhje me regjimin e kaluar dhe qëndrimin ndaj tij.

Të tilla pyetje janë bërë dhe bëhen edhe në Shqipërinë paskomuniste, siç janë: A duhen dënuar krimet dhe kriminelët e periudhës së diktaturës? Si duhet përcaktuar natyra e krimeve komuniste nëse ato bëheshin të mbështetur mbi ligje? Cilët janë kriminelët e vërtetë të regjimit komunist, udhëheqësit politikë apo hetuesit dhe gjykatësit? A kanë përgjegjësi udhëheqësit e lartë politikë të diktaturës komuniste? Cila është përgjegjësia penale e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit komunist për vrasjet, torturat dhe krimet e tjera të kryera? Si duhet vendosur drejtësia mbi krimet e kryera nën diktaturë? A duhen dëmshpërbyer dhe rehabilituar viktimat dhe familjet e viktimave të diktaturës? Si duhet të veprohet për të informuar opinionin publik dhe para së gjithave brezin e ri, mbi të vërtetën për diktaturën? A mund të ndërtohet një shoqëri demokratike pa bërë drejtësi për regjimin e vjetër komunist? A ka rrezik që vendosja e drejtësisë mbi krimet e diktaturës komuniste të sjellë përçarje dhe prishje të paqes shoqërore?

Përgjigjen e pyetjeve të tilla dhe diskutimin analitik mbi probleme të ngjashme mund ta gjejmë gjerësisht në fushën e re të studimeve dhe të praktikës gjyqësore, drejtësinë tranzitore. Gjithsesi, është e rëndësishme të analizohet dhe të arsyetohet në lidhje me disa nga problemet e parashtruara më sipër.

Si duhet përcaktuar natyra e krimeve komuniste nëse ato bëheshin të mbështetur mbi ligje?

Regjimi komunist u përmbys nëpërmjet revolucionit popullor, jo duke u përkujdesur që të mos shkeleshin ligjet që ishin në fuqi, por nëpërmjet shpërfilljes së tyre, si ligje që ishin vendosur nëpërmjet dhunës, demagogjisë dhe proceseve të votimit në mungesë të lirisë së njerëzve për të zgjedhur. Porë në këtë këndvështrim, ato ligje (siç ishte, për shembull, ai i dënimit të agjitacion propagandës antikomuniste) nuk mund të shërbenin si themel i dënimeve të drejta dhe të pakundërshtueshme, por vetëm si mjet i mbrojtjes së atij regjimi. Disa prej shkeljeve të atyre ligjeve, të cilat lidheshin me kundërshtimin e politikës komuniste, mund të vështrohen si fillesa të revolucionit popullor, që më vonë do të përmbyste regjimin komunist.

Si rrjedhojë, edhe pyetjes se “Cilët janë kriminelët e vërtetë të regjimit komunist, udhëheqësit politikë apo hetuesit dhe gjykatësit?” mund t’i përgjigjemi duke thënë se kriminelët e vërtetë ishin, para së gjithave, udhëheqësit e lartë politikë të regjimit komunist. Kjo nuk i përjashton nga përgjegjësia hetuesit dhe gjykatësit, sepse një pjesë e madhe e gjyqeve të asaj periudhe kanë qenë kryer mbi hetime dhe fakte të

pa vërtetë, ose pa fakte fare. Ekzistenca e një numri të madh, ende të papërcaktuar, të njerëzve të zhdukur nga regjimi komunist është një provë edhe më e fortë për këtë. Natyrisht, për hetuesit dhe gjykatësit, përgjegjësia duhet kërkuar dhe mbajtur në mënyrë konkrete duke u mbështetur në faktet akuzuese.

Prandaj edhe pyetja “A mund të ndërtohet një shoqëri demokratike pa bërë drejtësi mbi regjimin e vjetër komunist?” e nënkupton përgjigjen negative. Shqipëria nuk e ka bërë plotësisht drejtësinë për regjimin e vjetër komunist dhe, si rrjedhojë, tranzicioni i saj po vazhdon më gjatë se në vendet e tjera ish-komuniste. Debatimi politik ndërmjet të majtës dhe të djathtës është shumë i ashpër dhe shumë njerëz ndiejnë zhgënjim nga demokracia, sidomos shtresa e ish të përndjekurve politikë.

Në librin e tyre “Lindja e drejtësisë tranzitore si praktikë profesionale ndërkombëtare”, autorët ekspertë të drejtësisë tranzitore, Lefranc dhe Vairel shkruajnë: “Kohët e fundit, drejtësia tranzitore është bërë një ndër mjetet më të këshilluara për ndërtimin e paqes brenda një vendi që ka përjetuar luftë civile ose shtypje shtetërore. Sado të larmishëm mund të jenë përbërësit e saj, ajo ofron një përmasë të re të drejtësisë: rehabilitimin e viktimave, pjesërisht nëpërmjet dëmshpërblimeve, mbështetjes dhe përkrahjes, përgjithësisht duke u mbështetur mbi gjykimin e autorëve të krimeve”.¹

Në po atë libër, më tej, ata shkruajnë: “Modeli i drejtësisë tranzitore është bërë gjithnjë dhe më shumë pra, një mjet që është pjesë përbërëse dhe vjen duke u zgjeruar në tregun ndërkombëtar të punës, duke shkuar përtej mbështetjes dhe lartësimit të të drejtave të njeriut. ... seancat kualifikuese të organizuara nga Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzitore (ICTJ,) veprojnë si një hapësirë drejt së cilës ‘agjentët ndërkombëtarë’ konvergojnë, duke përgatitur një kalim nga fusha qeveritare drejt fushës ndërqeveritare, pikërisht po ashtu si edhe nga fusha ndërqeveritare drejt fushës qeveritare. ... ndërhyrja e ICTJ-së në më shumë se tridhjetë vende brenda një kohe të shkurtër shpjegohet nëpërmjet talentit të shfaqur nga anëtarët e kësaj organizate me synimin që të nxisin interesin e elitave të vendeve të ndryshme për praktikën më të mira të ‘drejtësisë tranzitore’”.²

Duke folur për nevojën e veprimit të drejtësisë tranzitore edhe në Shqipëri, studiuesi shqiptar Altin Gjeta shprehet: “Drejtësia tranzitore është shfaqur si një mekanizëm veprimtarie dhe hulumtimi që përqendrohet në mënyrën se si e trajtojnë shoqëritë trashëgiminë e shkeljeve të të drejtave të njeriut në të shkurarë, mizoritë masive apo forma të tjera të traumave të rënda shoqërore, me qëllim ndërtimin e një të ardhmeje më të drejtë, demokratike dhe paqësore”.³

E mbështetur në studimet dhe përvojën praktike të shumë rrethanave pasdiktatoriale, duke nisur që prej gjyqeve të Nurenbergut, të ngritur për të dënuar krimet e fashizmit, drejtësia tranzitore ka përpunuar dhe mbështetur shumë mekanizma të saj, që përgjithësisht janë amnistitë për njerëzit ndaj të cilëve janë kryer shkelje të të drejtave të njeriut nën diktaturë, seancat gjyqësore të rregullta

1 Lefranc, Sandrine and Vairel, Frederic, “The emergence of transitional Justice as a Professional International Practice”, Internet, link.springer.com/chapter/10.1007/978-90-6704-930-6_14, Abstract.

2 Lefranc, Sandrine and Vairel, Frederic, “The emergence of transitional Justice as a Professional International Practice”, Internet, link.springer.com/chapter/10.1007/978-90-6704-930-6_14, f.246

3 Gjeta, Altin, “Tranzicioni pa drejtësi në Shqipërinë paskomuniste: Ndërlikimet e tij mbi kujtesën kolektive dhe promovimin e demokracisë”, OSBE, Drejtësia dhe ndryshimi në Shqipëri, bot. 2020, f. 8

mbi shkeljet e të drejtave të njeriut nën diktaturë, ngritja e komisioneve të së vërtetës mbi të shkuarën diktatoriale, lustracioni ose parandalimi i pjesëmarrjes në detyra publike i njerëzve të cilët kanë kryer shkelje të të drejtave të njeriut në shoqërinë e mëparshme diktatoriale, dhënia e dëmshpërblimeve dhe rikthimi i pronave, mundësia për të shikuar dosjet e fshehta të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ngritja e përmendoreve dhe muzeve, veprimtaritë përkujtimore, botimi i librave dhe dokumenteve mbi krimet nën diktaturë, shpallja e periudhës së shkuar totalitare si e paligjshme, kërkimi i ndjesës publike, etj.

Në mbështetje të zbatimit praktik të drejtësisë tranzitore në vendet pas diktatoriale, janë krijuar disa organizma ndërkombëtare të rëndësishme. Po përmendim disa prej tyre.

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzitore (ICTJ) me vendndodhje në Nju Jork, është themeluar në vitin 2001 si një agjenci jofitimprurëse që merret me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në të gjitha vendet e botës. Natyrisht, ajo bashkëpunon edhe me Shqipërinë në lidhje me veprimtarinë për hulumtimin dhe bërjen e drejtësisë kundrejt regjimit diktatorial komunist.

Në fushën ndërkombëtare është edhe ICMP (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur), e cila është themeluar me nismën e Presidentit Bill Clinton në vitin 1996, dhe bashkëpunon me qeveritë për gjetjen e njerëzve të zhdukur si rrjedhojë e konflikteve, shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhunës së organizuar, etj. ICMP-ja është takuar për herë të parë me qeverinë shqiptare në vitin 2010 dhe ka arritur të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi në vitin 2018.

Ekzistojnë edhe dy organizma të OKB-së në kuadrin e OHCHR-së (Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, e krijuar në vitin 1993), që janë: WGEID (Grupi i Punës për Zhdukjet e Detyruara apo të Pavullnetshme) dhe CED (Komisioni për Zhdukjet e Detyruara).

Edhe në Shqipëri, ashtu si në gjithë vendet ish-komuniste, përpjekjet e para për të hapur rrugën ligjore për veprimin e drejtësisë tranzitore filluan menjëherë pas vendosjes së demokracisë.

Pas këtyre ndryshimeve demokratike në Shqipëri në fillim të viteve 1990, parlamenti shqiptar miratoi tri ligje të rëndësishme. Në vitin 1991, miratoi ligjin “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”. Në vitin 1995, u miratuan dy ligje të tjera të rëndësishme të emërtuara “Ligji për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare” dhe “Ligji për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” (i ashtuquajtur Ligji për verifikimet).

Në vitin 2008, u miratua edhe “Ligji për lustracionin”, i cili parashikonte të mos lejonte përfshirjen në detyra publike të shtetit demokratik të njerëzve të regjimit të vjetër komunist, por në vitin 2010, ai u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese. Ky vendim krijoi probleme në lidhje me zbatimin e drejtësisë tranzitore në Shqipëri. Një ligj i rëndësishëm është edhe ai “Për Dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”, i vitit 2007, i ndryshuar dhe përmirësuar disa herë më pas. Në mënyrë të veçantë, për të zhdukurit e regjimit komunist ka rëndësi edhe shtesa

që është bërë në nenin 74 të Kodit Penal (2013), që përcakton zhdukjen me forcë në radhën e krimeve kundër njerëzimit dhe shërben si themel për kërkimin e të zhdukurve të regjimit komunist.

Pak më pas, në vitin 2010, u themelua Instituti i ish të Përndjekurve Politikë. Studiuesi Sokol Lleshi thotë: “Themelimi i një Instituti u mbështet zyrtarisht nga Partia Demokratike, një parti politike e qendrës së djathtë [partia e parë opozitare në Shqipëri, shën. i aut., T. Starova]. Shpresohet që ai Institut të kishte, ligjërisht dhe praktikisht, të gjithë fuqinë simbolike të një instituti shtetëror, si edhe të kishte mundësi të pakufizuara për hulumtimin e arkivave të policisë së fshehtë komuniste. Nga këndvështrimi i tipareve zyrtare institucionale dhe i fuqisë simbolike, Instituti do të kishte të njëjtat arritje si institucionet e tjera të ngjashme. I themeluar në vitin 2010 dhe i vendosur në të njëjtën ndërtesë që kishte qenë vendndodhja e përfaqësuesit të Italisë fashiste në Tiranë, ai Institut u përqendrua në grumbullimin e dëshmimeve të të përndjekurve politikë, paraqitjen e rindertimeve grafike të kampeve të përqendrimit dhe botimin e një baze të të dhënave mbi viktimat”.⁴

Gjatë kësaj periudhe pas ndryshimeve demokratike në Shqipëri, u krijuan edhe shumë shoqata joqeveritare të ish të përndjekurve politikë që do merreshin me problematikën e shumtë dhe të larmishme të shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste.

Në 30 mars të vitit 2015 u krijua Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), si një institucion publik i pavarur që do të përqendrohej në detyrat e grumbullimit, ruajtjes dhe përpunimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të periudhës së diktaturës komuniste. Ky institucion ishte menduar si një mekanizëm që do të lehtësonte gjithë punën e vështirë të drejtësisë tranzitore në Shqipëri. Përgjatë pak viteve të ekzistencës së tij, ky institucion ka bërë përpjekje të rëndësishme për sensibilizimin e problemeve të drejtësisë tranzitore në Shqipëri përmes botimeve, konferencave dhe shpërndarjes së informacionit të kërkuar nga familjarët e ish të përndjekurve politikë.

Megjithatë, nga këndvështrimi i sotëm i drejtësisë tranzitore shqiptare, mbetet ende shumë për të bërë. Siç thotë studiuesi Altin Gjeta: “Drejtësia tranzitore është anashkaluar në masë të madhe në Shqipërinë paskomuniste, pjesërisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, financimit dhe interesit kërkimor për këtë çështje. Shumica e punimeve kërkimore janë kryer nga studiues të huaj. ... Ekziston një marrëveshje e përgjithshme ndërmjet studiuesve se autoritetet shqiptarë kanë dështuar në trajtimin e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e shtetit komunist”.⁵

Në Konferencën shkencore të organizuar nga AIDSSH-ja në maj të vitit 2019, drejtoresha e këtij institucioni, Gentiana Sula, shprehet: “Qasja e zakonshme ndaj sjelljeve të caktuara, krimeve, akteve të dhunës, keqtrajtimit apo mbështetjes së regjimit është relativizuar nëpërmjet shprehjeve të njohura ‘ashtu ishte koha’,

4 Lleshi, Sokol, *European Politics and Society*, ISSN: 2374-5118 (Print) 2374-5126 (Online)
Journal homepage: <https://www.tandfonline.com/loi/rpep21>

5 Gjeta, Altin, “Tranzicioni pa drejtësi në Shqipërinë paskomuniste: Ndërlikimet e tij mbi kujtesën kolektive dhe promovimin e demokracisë”, OSBE, *Drejtësia dhe ndryshimi në Shqipëri*, bot. 2020, f. 6

‘ashtu thoshte ligji’, ‘çdo gjë është kryer në zbatim të ligjit’, duke sjellë, për pasojë, qëndrime pranuese përballë një shteti që paska qenë i mirëorganizuar me ligje të drejta”.⁶

Ky është një fakt shumë i trishtë për Shqipërinë, por është krejtësisht i vërtetë edhe për ditët e sotme. Vendosja para drejtësisë e autorëve të përndjekjeve të regjimit komunist i është lënë harresës, po të përjashtojmë disa gjyqe farsë që janë bërë ndaj ish-elitës komuniste, ku shkak i dënimit ishte thjesht shpërdorimi ekonomik vetjak, ose siç thuhet rëndom me ironi në opinionin publik shpërdorues të sasisë së kafesë”.

II. Përmasat tragjike të shkeljes së të drejtave të njeriut në Shqipërinë komuniste dhe të njerëzve të zhdukur nga regjimi

Përmasat e krimit komunist në Shqipëri janë shumë të dhimbshme. Janë të paktën katër fakte që e bëjnë atë një krim të tejskajshëm, krahasuar me vendet e tjera ish-komuniste: përqendrimi mbi shtresën e intelektualëve, egërsia e persekutimit dhe krimit ndaj grave, rrëmbimi i pronave dhe pasurive private dhe numri i madh i njerëzve të zhdukur.

Siç shprehet autorja Fatbardha Saraçi në librin e saj “Kalvari i grave në burgjet e komunizmit”: “...rreth 10% e të pushkatuarve në Shqipëri nga diktatura komuniste ishin gra [457] ... nga 308 raste gjithsej me njerëz që humbën ekuilibrin mendor, një pjesë ishin gra e vajza. U dënuan politikisht 7,367 dhe u internuan 10,792 gra e vajza”.⁷ Krahasuar me numrin e popullsisë, përmasat e këtij krimi komunist kanë qenë të jashtëzakonshme.

Pjesa më e madhe e të përndjekurve dhe të zhdukurve nga regjimi komunist kanë qenë njerëz të arsimuar dhe intelektualë të fushave të ndryshme. Një pjesë e tyre u vranë menjëherë pas mbarimit të Luftës II Botërore dhe çlirimit të Shqipërisë, pa kurrfarë akuze dhe gjykimi ligjor, por thjesht si gjoja bashkëpunëtorë të pushtuesve. Të tjerë u vranë me procese gjyqësore tërësisht të sajura, si ai i grupit të 16 deputetëve të opozitës të vranë në vitin 1947 (Shefqet Beja, Riza Alizoti, Sulo Klosi, Selaudin Toto, Salim Kokalari, Irfan Majuni, Enver Sazani, etj.), i 10 inxhinierëve të tharjes së kënetës së Maliqit të vranë në vitin 1946 (Abdyl Sharra, Kujtim Beqiri, Zyraka Mano, Pandeli Zografi, Vasil Mano, Jani Vasili, etj.), i 22 intelektualëve të vranë në vitin 1951, gjoja për shkak të komplotit të bombës së vendosur në Ambasadën Sovjetike në Tiranë (Sabiha Kasimati, Tefik Shehu, Hekuran Troka, Haki Kodra, Ali Qoralii, Jonuz

Kaceli, Gafur Jegeni, Qemal Kasoruho, Reiz Selfo, Gon Temali, Mehmet Shkupti, etj.), dhe shumë të tjerë, të përndjekur politikisht dhe të dënuar gjatë gjithë kohës së ekzistencës së regjimit komunist, si Gjergj Kokoshi, Pjetër Arbnori, Qenan Dibra, Irfan Hysenbegasi, Thoma Orogollai, etj. Të gjitha historitë e tyre vetjake të përndjekjes politike janë kryesisht të sajara dhe shumë tragjike, por e vërteta madhore është se ata ishin paralajmëtarë të diktaturës së egër komuniste që po vendosej në Shqipëri. Ndërkohë, përndjekjet politike të njerëzve nëpërmjet mbajtjes nën mbikëqyrje me bashkëpunëtorë të fshehtë të Sigurimit të Shtetit, si dhe me krijimin e dosjeve të fshehta, arrijnë një shifër shumë më të madhe. Ndër këto dosje veçojmë edhe gratë e përndjekura dhe të pushkatuara, si intelektualja e shquar Sabiha Kasimati, Zyraka Mano (e pushkatuar në gjendje shtatzënie me grupin e Maliqit), Elisabeta Spiragu, Mergjuze Cafaj, Mime Hamzaj, Katerina Nik Bibaj, Erifili Bezhani, Musine Kokalari, Drita Kosturi, Raile Luzi, Frida Sadedini, etj.

Po japim në vijim disa të dhëna, pak të njohura, nga historitë e përndjekjes çnjerëzore të grave.

Fati tragjik i avokates Erifili Bezhani⁸ është një shembull i mënyrës se si e trajtoi, deri në zhdukje, një pjesë të mirë të shtresës intelektuale regjimi diktatorial i Hoxhës. E diplomuar shkëlqyeshëm në Francë për Drejtësi, ajo kthehet në vitin 1943 në Shqipëri. Pas luftës, ajo shprehet të afërmit e saj në lidhje me terrorin komunist se “Është një reprezalje e frikshme, jashtë shembullit të vendeve evropiane, ndaj duhej ndalur”. Për mendimet e saj, ajo arrestohet dhe dënohet me 20 vjet burg. Pas burgimit, në vitin 1958, e dënuan të punonte në fshirjen e rrugëve të Tiranës dhe vetëm në turnin e natës. Pas kësaj pune poshtëruese, ajo sëmuret dhe vdes gjatë një operacioni në spital, në shkurt të vitit 1959.

Është edhe historia e dhimbshme e Marie Tucit,⁹ gruaja e vetme ndër 38 martirët e Kishës Katolike, e cila u vra me tortura barbare fizike dhe psikologjike në tetor të vitit 1950. Ajo u arrestua dhe pësoi fatin e saj tragjik në moshën 22 vjeçare, kur ishte mësuese në Mirditë, vetëm sepse u shpreh kundër poshtërimit që i bëhej Kishës Katolike nga komunistët.

Disa mijëra gra të tjera, të cilat nuk pranuan të divorcoheshin nga burrat për të krijuar lehtësira për veten dhe familjarët, përjetuan vuajtjet e egra bashkë me familjet e tyre në kampet e internimit. Siç shprehet përsëri autorja Saraçi në librin e saj për ato gra: “U bënë heroina duke i ndjekur për vite me radhë, duke udhëtuar në të ftohtë apo në të nxehtë, në këmbë apo mbi kamionë të ngarkuar me dru, duke fjetur rrugëve, sepse dyert e banorëve pranë burgjeve dhe kampeve të punës nuk hapeshin për to, nga frika e Sigurimit të Shtetit”.¹⁰

Dokumentet e shkruara dhe rrëfimet e familjarëve të ish të përndjekurve tregojnë për një numër shumë të madh të të zhdukurve nga regjimi. Në një raport mbi një studim të kryer nga ekspertë të ICMP-së (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e

8 <https://kujto.al/fati-tragjik-i-erifili-bezhanit-avokatja-e-pare-shqiptare-qe-vuajti-burgun-e-burrelit-dhe-perfuindoi-si-fshesaxhije/>

9 <https://kujto.al/mesuesja-qe-vdiq-nga-torturat-si-e-percmoi-kryehetuesin-e-tmerrshem/>

10 Saraçi (Mulleti), Fatbardha, “Kalvari i grave në burgjet e komunizmit”, f. 191

Zhdukur) në vitet 2018-2020 me mbështetjen e BE-së, thuhet: “Është vlerësuar se për periudhën 1944-1991, në kohën e regjimit komunist, në Shqipëri ka rreth 6 mijë njerëz të zhdukur. Sipas të dhënave zyrtare, gjatë kësaj periudhe janë vrarë 5,501 njerëz të akuzuar për arsye politike. Trupat e tyre nuk u janë kthyer kurrë familjeve. Të dhënat zyrtare tregojnë gjithashtu se edhe 987 të burgosur të tjerë politikë kanë vdekur për shkaqe të ndryshme në burgjet dhe kampet e përqendrimit të Shqipërisë. Vendndodhja e eshtrave të tyre është e panjohur nga të afërmit e mbijetuar”.¹¹

Mbështetur në literaturën e gjerë të drejtësisë tranzitore dhe dokumente të shumta mbi përndjekjen komuniste në Shqipëri, arsyetimet rreth shkaqeve që mund ta kenë çuar regjimin komunist shqiptar në zhdukjen pa ligj të njerëzve të përndjekur ose në zhdukjen e trupave të atyre që janë pushkatuar, të bëjnë të mendosh se kanë qenë në vazhden e trashëgimisë së terrorit politik që e kishte prejardhjen qysh prej diktaturës jakobine të Francës, apo diktaturës komuniste të proletariatit të Leninit dhe Stalinit në Bashkimin Sovjetik. Si çdo diktaturë, edhe ajo komuniste shqiptare ishte e vetëdijshme se nëse ekzekutimet politike do të ishin të rralla, njerëzit e përndjekur do të përbënin rrezik të përhershëm për atë regjim, nëpërmjet shprehjes së mendimeve të tyre kritike mbi regjimin komunist dhe mungesën e lirisë dhe jetës normale të njerëzve. Po ashtu, nëse trupat e njerëzve të pushkatuar për arsye politike do të varroseshin në mënyrë normale, ata do të mund të shndërroheshin në simbole konkrete dhe frymëzuese të zhgënjimit dhe urrejtjes ndaj regjimit komunist. Zhdukja e trupave të të përndjekurve politikë të ekzekutuar krijonte një trysni të fortë psikologjike mbi të afërmit e viktimave dhe shoqërinë në tërësi, se krimet e tyre kishin qenë aq të rënda sa u mohojë edhe varri dhe nderimi pas vdekjes, që bënin pjesë në traditat njerëzore të zakonshme të të gjitha kohëve dhe të të gjithë popujve.

Ndër shkeljet e hapura dhe çnjerëzore të të drejtave të njeriut në Shqipëri kanë qenë edhe grabitjet, nëpërmjet sekuestrimeve, të pasurive private në formën e parave ose objekteve të tjera të veçanta, si shtëpi, sende me vlerë, etj.

Gjatë periudhës së diktaturës komuniste mund të vërehen qartë të paktën dy forma të përndjekjeve politike në përputhje me dy periudha historike. Prej vitit 1944 deri në mesin e viteve 1950, janë ushtruar forma më publike dhe të egra të përndjekjes politike, ndoshta edhe për shkak të faktit se ende kishte iluzione ndër intelektualët se regjimi i ri do të ishte i llojit të demokracive perëndimore dhe për këtë arsye ata flisnin hapur mbi të metat e tij. Është e mirënjohur se Sabiha Kasimati ia kishte thënë hapur dhe me ironi diktatorit Enver Hoxha se “duke vrarë të gjithë intelektualët atij i mbetej ta ndërtonte vendin vetëm me këpucarët dhe teneqexhinjtë”.

Një rast tjetër, shumë domethënës, është edhe ai i intelektualit dhe arsimtarit patriot Edip Tërshana, i cili u drejtua hapur kundër politikës së diktatorit. Në një letër që i shkruante Enver Hoxhës dhe që iu gjet në xhep para pushkatimit, më 18 janar 1948, ai e akuzon atë për tradhti ndaj Shqipërisë dhe Kosovës*, në bashkëpunim me jugosllavët. Në letër ai shprehet se: “Jam kundër për vrasjet me gjyq dhe pa gjyq që i bëhen këtij populli... Kjo është tradhti... Jam kundër këtij pushteti, se

¹¹ ICMP Report, Press Release, 2 March, 2021

* Të gjitha referencat për Kosovën, qofshin ato për territorin, institucionet apo popullsinë, duhen kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

është spekulator tue grabit popullin me ligj dhe mallin e sekuestruar nga tregtarët po ia shet më shtrenjtë se ç'e kishin ata, duke lanë në rrugë një numër familjesh të tregtarëve, kinse spekulatorë. ... Jam kundër thirrjes 'Jemi bij të Stalinit'... Jam kundër, sepse nuk ka liri fjale dhe shtyp të lirë. Ka vetëm terror...".¹²

Periodha tjetër, pas mesit të viteve 1950 deri në prag të viteve 1990, do të shfaqte forma njëloj të egra, por më të fshehura të përndjekjes politike. Në këtë periudhë, diktatori Hoxha filloi përndjekjet edhe në radhët e udhëheqjes komuniste dhe të bashkëpunëtorëve të tij, pas zhvillimit të Konferencës së Partisë të Tiranës, të prillit 1956, ku pati kritika të forta kundër kultit të individit të diktatorit. Në këtë periudhë, përmasat e mbikëqyrjes së fshehtë të njerëzve, sidomos të intelektualëve dhe të familjeve me prejardhje nga shtresa e pasur, u rritën në mënyrë të jashtëzakonshme.

Në këtë periudhë regjimi komunist përpiquej të mbante gjallë dhe të shtonte ndjenjën e frikës për cilindo që mund të mendonte apo fliste për të metat e atij regjimi. Madje kishte një politikë të pashkruar mbi sasinë e ndëshkimeve që duhej të jepeshin kundrejt kundërshtarëve të mundshëm të regjimit. Është interesant një episod që tregohet nga një i ri i punësuar si hetues në qytetin e Korçës, në fillim të viteve 1980. I sapodiplomuar dhe me njëfarë liberalizmi, edhe për shkak të moshës dhe formimit të tij, pasi kishte kaluar një vit, ai ende nuk kishte sjellë asnjë fakt për veprimtarinë e "armikut të klasës". Duke qenë se po binte në sy për keq dhe si i paaftë, shefi i tij, për ta shpëtuar nga kritikati i kishte thënë: "Në qoftë se mbetesh keq dhe pa fakte, atëherë shko pranë ndonjë dyqani ushqimor ku shkojnë për të blerë disa gra sovjetike të martuara me shqiptarë, dhe meqenëse ato gjithnjë ankohen, ti mund t'i shënosh fjalët e tyre në një dosje denoncimi. Kështu do të jesh në rregull me punën".¹³

Një episod tjetër i treguar nga një ish i burgosur e tregon edhe më qartë se kishte një politikë të caktuar të regjimit komunist mbi sasinë e dënimeve që duheshin dhënë, thjesht si mjet trysnie të fortë psikologjike mbi popullin. Ai rrëfëhet nga një i burgosur i moshuar, i cili ishte futur në burg me shkaqe krejt të sajua. Me mënyrën e tij të mençur, ai ua bënte të ditur të gjithëve, madje edhe gardianëve të burgut, se ishte dënuar krejt kot. Kështu, sa herë që në bisedë duhej të përmendej fjala "hetues", ai me qëllim e shtrembëronte atë duke thënë "hutuesi". Nënkuptimi për ata që kuptonin ishte i qartë: hetuesi është ai që në aktakuzë shkruan atë çfarë do vetë, ndërsa gardianët e paditur e korrigjonin duke i treguar se duhet thënë hetues, jo hutues.¹⁴

Një shembull tjetër tipik për përndjekjen e grave është ai që dëshmohet nga Dosja formular e kategorisë 2/A (kategoria më e lartë e përndjekjes politike nga siguri i shtetit) mbi Tefta Koço Tasen. Në vitin 1975, ajo internohet në fshatin Grabian të Lushnjës, kurse në vitin 1979 merret në përpunim (mbikëqyrje nga agjentët e Sigurimit) si njeri që bënte propagandë për llogari të italianëve, duke e motivuar në dy drejtime, mbi gjendjen ekonomike të keqe të vendit dhe mbi stacionet e radios italiane, që janë më të mira se të Shqipërisë për çka transmetojnë. Në dosje tregohet

¹² Gazeta Rajoni, <https://gazetarajoni.com/shqipshqiptari-i-vetem-ne-planet-qe-guxoi-dhe-i-tha-te-verteten-e-nver-h-oxhes-po-vr-et-popullin-po-i-kthen-ne-skill-ever/>, 28 tetor 2021

¹³ Sipas bisedës së drejtpërdrejtë me ish-hetuesin, Z. P. Lamaj.

¹⁴ Sipas bisedës së drejtpërdrejtë me ish të burgosurin I.Farka.

se si agjentë të ndryshëm, me pseudonimet “Zambaku”, “Shpresa”, “Vollga”, “Lindita”, “Bjeshka”, etj., nëpërmjet informacioneve të grumbulluara mbi Teftën përgatitën demaskimin e saj para popullit në vitin 1979 dhe disa muaj më pas arrestimin e saj, duke e dënuar me tetë vjet heqje lirie. Më tej, edhe brenda në burg, përndjekja e saj vazhdonte. Pas provokimeve që bënin informatorë të ndryshëm brenda burgut, ata e mbushnin dosjen e saj me informacione të ndryshme, si parapëlqimin e Teftës për programet televizive jugosllave, vlerësimin e figurës së Titos, thënien e saj se gratë shqiptare 50 vjeçare duken shumë më të moshuara se moshataret e tyre jashtë shtetit, përmendjen se gjellën që u japin në burg nuk e ha as qeni, shprehjen se Tefta nuk ka besim te shtypi shqiptar, etj. Edhe pas daljes nga burgu, në vitin 1982, dhe vendosjes së saj përsëri në Grabian, Tefta përndiqet nëpërmjet mbikëqyrjes së fshehtë nga informatorët e Sigurimit, të cilët merrnin të dhëna mbi të nëpërmjet miqësisë që kishin me vëllezërit e saj. Dosja e saj u arkivua vetëm në 11 qershor të vitit 1991, pas ndryshimeve demokratike.

Histori të ngjashme gjejmë edhe për gra të tjera të qarkut të Tiranës, si Laura Gjeto Keqi, Fatbardha Qorri, Emine Muharrem Shima, Fatime Dega, Asamble Hatibi, Fatime Hoxha, Fatime Reka, Rukije Pame, Xhuljeta Cuka.

Raste të tjera tragjike janë të shumta. Po përmendim vetëm disa prej tyre.¹⁵

Një pjese të grave të përndjekura dhe të ekzekutuara nga regjimi komunist nuk u dihet ende varri. Në gjithë Shqipërinë, janë rreth 22 gra të përndjekura, të zhdukura nga regjimi komunist, por kjo është ende një shifër jopërfundimtare.

Për Qarkun e Tiranës, të zhdukura nga regjimi komunist për arsye politike dhe ende pa një vend varrimi janë këto gra:

Liri Besim Gega [Ndreu] (lindur në Gjirokastrë, më 17 shkurt 1917 dhe dënuar me gjykim me ekzekutim më 23 shtator 1956),

Hanife Ramadan Karkuli (lindur në Çamëri, në vitin 1902, dënuar me gjyq për veprimtarinë e saj gjatë luftës dhe ekzekutuar më 25 qershor 1945),

Hatlije Beqir Tafani (lindur në vitin 1913 në Tiranë dhe vdekur në hetuesi më 16 shtator 1945, pa dalë në gjyq).

Hektor Sejko tregon se si u rrëmbye, më 28 korrik 1960, nga tre agjentë të Sigurimit, dhe u vra pa gjyq, më 24 shkurt 1962, babai i tij Taho Sejko, eshtrat e të cilit ende nuk dihet ku ndodhen.

Durim Hatibi tregon se babai i tij, Galip Hatibi, u rrëmbye nga Sigurimi i Shtetit kur ishte 26 vjeç dhe pasi u torturua, u dogj i gjallë me benzinë, kurse eshtrat e tij ende nuk dihet ku janë.

Angjelina Preka (Kovaçi) rrëfen për të vëllanë, priftin Dom Engjëll Kovaçi, të cilin e arrestuan për herë të dytë, duke e akuzuar se kishte vlarë dikë brenda në kishë. Pas kësaj e pushkatuan dhe eshtrat e tij ende nuk janë gjetur.

Përndjekjeve të egra të diktaturës komuniste nuk i shpëtuan as bashkësitë fetare në Shqipëri, ndër të cilat spikatën në egërsi ato kundër klerit katolik. Do të mjaftonte

vetëm një pjesë e vogël, e nxjerrë nga libri i At Zef Pllumit, për të kuptuar përmasat e tragjedisë së diktaturës komuniste mbi shqiptarët: “Dhuna titanike e quejtun ‘proletare’, e ushtrime ditë e natë, gjithkund e papushim, pa dallue fshat, as qytet, e shoqueme me britmat e slloganët papagalë dhe torturat çnjerëzore, me rrenat e kaçarrenat e njerëzve servilë o t’pagueu: mbas gjithë atyne pushkatimeve të përgjakshme, burgimeve e shpërnguljeve të dhunshme masive, ia duelën me e përkulë popullin e lirë të Shqipnisë dhe kështu dhuna partizane ia duel me u ba Qeveri!”¹⁶

III. Përndjekja politike e grave nën regjimin komunist

Në vijim është rasti i së përndjekurës dhe së burgosurës politike Asamble Rexhep Hatibi nga Tirana.¹⁷

E lindur në vitin 1924, me prejardhje nga një familje tregtare, Asamble Hatibi kishte përfunduar Institutin Femëror të Tiranës dhe kishte qenë veprimtare në përpjekjet kundër pushtuesve fashistë italianë në Shqipëri, madje edhe ishte arrestuar dhe dënuar nga ata. Njohëse e disa gjuhëve të huaja dhe e kulturuar nëpërmjet leximeve të pandërprera dhe interesave të saj të gjera. Pasi kishte punuar për disa vjet në Ministrinë e Bujqësisë dhe në Institutin e Lartë Bujqësor, ajo ishte caktuar punonjëse e thjeshtë në Ndërmarrjen Artistike “Migjeni”.

Nëpërmjet disa agjentëve të fshehtë të Sigurimit të Shtetit dhe sidomos, agjentes “Shigjeta”, të cilën znj. Hatibi e mendonte si shoqen e saj, kishin filluar dyshimet se ajo kryente veprimtari agjitacioni dhe propagande kundër “partisë dhe pushtetit popullor”. Në informacionet e shumta që kishte dhënë “Shigjeta”, thuhej se znj. Hatibi mendonte se “Koçi Xoxe me Sekretarin e Parë [Enver Hoxhën, shën. i autorit] ishin njëlloj, kishin punuar bashkë, porse kur ky pa se Koçin e donin më shumë dhe mund ta zëvendësonin me të, atëherë e sulmoi Koçin”... “në çdo dhjetë vjet bëhet një fushatë vrasjesh të kundërshtarëve...” ...“udhëheqësin e cilëson vrasës, kriminel, fajtor, bashkëpunues me armiqtë e partisë, vrasës të Musine Kokalarit” ...“gjendja ekonomike e vendit është e tillë saqë duhet mbajtur radhë edhe për të blerë kastravecë”... etj., etj. Në vijim të shumë informacioneve të tilla nga agjentja “Shigjeta” dhe agjentë të tjerë, si ai me pseudonimin “Arbëri”, për mbikëqyrjen dhe provokimin e znj. Hatibi, si dhe pasurvejimeve të imta të banesës së saj dhe bisedave që bëheshin atje, më në fund, në tetor të viti 1978, ajo arrestohet për “veprimtari të mprehtë agjitacioni dhe propagande armiqësore kundër partisë dhe pushtetit popullor”. Pas kësaj, vihet në punë një plan shumë i hollësishëm veprimesh, me qëllim që të plotësohej dosja e saj “armiqësore” përpara se të dërgohej në gjykatë. Hetuesia jep udhëzime për studimin e materialeve armiqësore mbi burrin e saj Galip Hatibi, i dënuar si agjent i amerikanëve, studimin e kaligrafisë së znj. Hatibi, për shkak

16 Pllumi, At Zef, “Rrno vetëm për me tregue”, Sh. Botuese 55, bot. 2006, f.35.

17 Të gjitha informacionet e paraqitura në këtë pjesë të punimit mbështeten në “Dosjen agjenteurale me pseudonimin ‘Shtriga’”, Dosja 11554-A, Fashikulli 1, Nr. 1334.

të dyshimit se kishte dërguar një letër anonime në udhëheqjen e partisë, kontrollin e letërkëmbimit që kishte me njerëzit e saj në Turqi dhe Jugosllavi, kontrollin dhe sekuestrimin e librave që kishte në shtëpi, zhvillimin e një hetuesie intensive me znj. Hatibi për të gjetur lidhjet e saj me njerëz jashtë vendit, frymëzuesit e veprimtarisë së saj propagandistike, gjetjen e burimit të të dhënave për mendimet që shprehte, gjetjen e elementëve armiqësorë ndër shokët dhe shoqet e saj, gjetjen e pasurive të saj jashtë vendit, përpunimin e veçantë në dhomën e izolimit (çka nënkuptonte të paktën diçka detyruese për të treguar), ruajtjen e fshehtësisë së agjentës “Shigjeta”, mbikëqyrjen e djalit të saj, Durim Hatibi, shfrytëzimin e mundësisë për të rekrutuar si agjentë të fshehtë ata që kishin folur me znj. Hatibi, etj.

Pas kësaj veprimtarie hetuese intensive, më 17 mars të vitit 1979 dosja iu dërgua Gjykatës së Tiranës me akuzën për agjitacion dhe propagandë armiqësore, mbështetur në Nenin 55 të Kodit Penal. Në vendimin pasues të gjykatës, u përmend se veprimtaria e saj armiqësore kishte filluar qysh në vitin 1964. Znj. Hatibi u dënua me 7 vjet burgim.

Kaq informacion dhe vetëm për një punonjëse, mjafton për të kuptuar krejtësisht qartë se çfarë mekanizmi gjigant shtetëror vihej në lëvizje për të mbrojtur regjimin nga idetë e rrezikshme të shumë njerëzve.

Znj. Hatibi u lirua në vitin 1982, duke përfitur nga një amnisti, por dosja e saj u mbyll vetëm në vitin 1991. Gjatë këtyre tetë viteve, ajo vazhdonte të ishte nën mbikëqyrjen e Sigurimit të Shtetit.

Është për t'u shënuar se gjatë procesit të hetimit intensiv të znj. Hatibi, dy njerëz u rekrutuan si agjentë të fshehtë nëpërmjet trysnisë psikologjike. Ndërkohë, një njeri tjetër u detyrua të vetëvritej për të mos u bërë agjent i fshehtë i Sigurimit të Shtetit [emrat e tyre nuk po i japim, por ata ndodhen në dosjen përkatëse. Shën. i autorit].

Sot, shumë vjet më pas, të gjithë e dimë se znj. Hatibi dhe gjithë të përndjekurit dhe të zhdukurit politikë të regjimit komunist thoshin vetëm të vërteta në bisedat e tyre, porse ato binin ndesh me gënjeshtrenë e madhe të regjimit komunist, e cila mbrohej me “ligj” dhe me institucionet ligjzbatuese.

IV. Korniza ligjore dhe përpjekjet praktike zyrtare për kërkimin dhe gjetjen e njerëzve të zhdukur nga diktatura komuniste

Me vendosjen e demokracisë në Shqipëri, në vitin 1992, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të bërë drejtësi për krimet e komunizmit dhe mijëra viktimat e tyre, së bashku me familjarët, si dhe për rehabilitimin dhe dëmshpërblimin e tyre ekonomik. Në këtë proces shumë thelbësor për shtetin e ri demokratik shqiptar

bënte pjesë edhe gjetja e eshtrave dhe varreve të të ekzekutuarve të diktaturës komuniste.

Në lidhje me njerëzit e zhdukur nga dhuna politike, ekziston edhe legjislacioni përkatës ndërkombëtar, siç është Konventa Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë”. Në dy paragrafët e Nenit 1 të saj shkruhet: “1. Askush nuk do të jetë subjekt i një zhdukjeje me forcë. 2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje lufte a rrezik lufte, paqëndrueshmëri e brendshme politike ose çdo lloj tjetër gjendjeje e jashtëzakonshme, nuk mund të nxirret si përligje për një zhdukje me forcë”.¹⁸

Shqipëria mori përsipër edhe detyrime ligjore për të vendosur drejtësi për njerëzit e zhdukur nga regjimi komunist dhe familjet e tyre.

Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Statuti i Romës), nënshkruar nga Shqipëria më 18 korrik 1998 dhe instrumenti i ratifikimit depozituar më 31 janar 2003, e parashikon krimin e zhdukjes me forcë si krim kundër njerëzimit. Ky instrument ligjor parashikon detyrimet e shteteve për të kryer hetime efektive në lidhje me personat e zhdukur.¹⁹ Pra, familjet shqiptare e zotërojnë për një kohë të gjatë të drejtën ligjore që të kërkojnë hetime për të zhdukurit e tyre nga diktatura komuniste dhe të ndihmohen nga shteti.

Më vonë, në Forumin e Paqes në Paris, më 12 nëntor 2018, “Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur [ICMP] rishikoi Deklaratën e ICMP-së mbi rolin e shtetit në trajtimin e çështjes së personave të zhdukur... me qëllim mbështetjen e zbatimit të parimeve të Deklaratës në mënyrë universale dhe në të gjitha rrethanat kur personat zhduken ...”.²⁰

Gjithashtu, në po atë Raport, të cilin e kemi lartpërmendur mbi një studim të kryer nga ekspertë të ICMP-së (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) në vitet 2018-2020 me mbështetjen e BE-së, eksperti Mathew Holliday, kreu i programit të ICMP-së për Ballkanin, shprehet: “Rekomandimet e Raportit kërkojnë siguri që rastet e njerëzve të zhdukur të hetohen siç duhet dhe të respektohen të drejtat e familjeve në lidhje me të vërtetën e munguar, drejtësinë dhe dëmshpërblimet. Autoritetet shqiptare kanë një detyrim ligjor që të mbajnë përgjegjësi për njerëzit e zhdukur gjatë periudhës komuniste – përgjegjësia shtetërore dhe veprimi shtetëror janë thelbësorë”.²¹

Në Shqipëri, institucionet që kanë detyrimin ligjor për t’u marrë me njerëzit e zhdukur janë policia, prokuroria, gjykatat, AIDSSH-ja, organet e qeverisjes vendore, Instituti i Mjekësisë Ligjore, si dhe disa organizata të veçanta të shoqërisë civile.

Me gjithë ekzistencën e një kornize ligjore të qartë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe gjithë mekanizmave për përparimin e Shqipërisë në çështje praktike të drejtësisë së saj tranzitore [Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Nenet 3, 21, 25,

18 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Udhërrëfyes”, bot. 2021, f.9.

19 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Udhërrëfyes”, bot. 2021, f.48.

20 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Udhërrëfyes”, bot. 2021, f.49.

21 ICMP Report, Press Release, 2 March, 2021.

27; Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 74, 109/c; Ligji Nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Sigurimit të Shtetit, Neni 3 (8)], sidomos në çështjen e të zhdukurve nga diktatura komuniste, arrijtjet lenë shumë vend për kritika të forta.

Studiuesi Sokol Lleshi shkruan: “Përpjekjet fillestare për krijimin e procesit të pajtimit duke i konsideruar qytetarët si bashkëvuajtës dhe bashkëfajtorë të regjimit të kaluar, nuk ishin të frytshme. Procesi i hulumtimit të së kaluarës së diktaturës komuniste dhe i krijimit të ndryshimeve ligjore drejt një rendi politik liberal në mesin e viteve 1990 u politizua dhe u ndërpre pas krizës shtetërore të vitit 1997. Mekanizmat fillestarë të përbaljes me të kaluarën komuniste nuk e lejuan mundësinë e futjes në arkivat e policisë së fshehtë. Përmasa e vazhdueshme e trajtimit të së kaluarës komuniste për Shqipërinë ka qenë njohja ligjore dhe pranimi i vuajtjeve të të përndjekurve politikë, përfshirë një proces të vazhdueshëm të shpërndarjes së dëmshpërblimeve financiare”.²²

Edhe në vitin 2019, në “Udhërrëfyesin” e AIDSSH-së shkruhet: “Edhe pse që pas vitit 1991 janë ndërmarrë hapa ligjorë dhe institucionalë për të garantuar ushtrimin e të drejtave nga viktimat e komunizmit dhe familjarët e tyre, ende ka shumë për të bërë. Një sfidë e madhe ka qenë dhe mbetet gjetja, identifikimi dhe rikuperimi i trupave të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit, kur deri më sot vetëm një numër i vogël i tyre janë zbuluar e identifikuar përmes përpjekjeve *ad hoc* të kryera nga familjet e të zhdukurve”.²³

Në të njëjtin vit, në dokumentet publike të AIDSSH-së gjejmë të shkruar qartë se “Rehabilitimi i viktimave të krimeve komuniste, ridimensionimi i figurës së të pafajshmëve dhe nderimi i sakrificës së atyre që ia dolën me dinjitet njerëzor është një hap i madh që duhet bërë sa më shpejt”.²⁴

Sado e ndërlikuar dhe e vështirë të ketë qenë dhe të jetë çështja e kërkimit dhe gjetjes së njerëzve të zhdukur nga diktatura komuniste shqiptare, prapambetja, vonesat dhe mosarritjet në këtë fushë janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e qeverive shqiptare dhe institucioneve përkatëse të drejtësisë tranzitore.

Përveç kësaj, është shumë shqetësues përfundimi në të cilin arrin AIDSSH-ja kur shprehet: “Propaganda e madhe komuniste, fshehja e informacionit, ruajtja me sekretin më të madh, pamundësimi i njohjes së realitetit të dhunës së shtetit të diktaturës së proletarietit ka krijuar iluzione të shumta tek ajo pjesë e popullsisë që nuk vuajti nëpër burgje a internime. Vijimi i heshtjes edhe gjatë viteve të demokracisë dhe mosqartësimi i përmasave të asaj dhune ka lënë boshllëk të madh dhe po shoqërohet me procese regresive, të tilla si rilindje të nostalgjive për të kaluarën ‘e ndritur’ socialiste, nderimi i diktaturës, diktatorit dhe njerëzve që u shërbyen atyre, etj.”²⁵

22 Lleshi, Sokol, European Politics and Society, ISSN: 2374-5118 (Print) 2374-5126 (Online)

Journal homepage: <https://www.tandfonline.com/loi/rpep21>

23 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Udhërrëfyes”, f. 10.

24 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Platforma e dëshmimeve gojore”, broshurë, bot. 2019.

25 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Instalacioni artistik”, broshurë, bot. 2019.

Të njëjtin shqetësim e gjejmë edhe në dokumente të tjera të AIDSSH-së: “Krimet e komunizmit për një kohë shumë të gjatë, rreth 28 vite demokraci, kanë mbetur jashtë vëmendjes së publikut dhe larg çdo qasjeje reflektuese... Mosinteresimi shoqëror dhe ndonjëherë mospranimi i së vërtetës së hidhur të krimeve komuniste është shqetësim real në Shqipëri”.²⁶

Studiuesja Jonida Jani shkruan se “Ndërkohë që ishte një nga vendet e para në Ballkan që nisi reformat e drejtësisë tranzitore, Shqipëria ka dështuar në trajtimin e së shkuarës. ... Drejtësia tranzitore shihet si një mjet drejt demokratizimit dhe kultura politike si një faktor që shpjegon dështimin e masave të drejtësisë tranzitore”.²⁷

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes së kërimit dhe gjetjes së të zhdukurve nga diktatura komuniste shqiptare, tregohet qartë mungesa e vullnetit institucional zyrtar, por ndoshta edhe shpërfillja që vjen si rrjedhojë e vazhdimit të ndikimit të mendësisë së trashëguar të ish-regjimit komunist. Mund të ketë edhe shkaqe të tjera që lidhen me ekspertizën dhe mjetet konkrete përkatëse që nevojiten për çështjen e të zhdukurve, por të gjitha ato nuk janë parësore krahasuar me mungesën e vullnetit zyrtar institucional.

V. Mbi shkaqet e vonesës së gjatë të kërimit dhe gjetjes së njerëzve të zhdukur

Në studimin e tyre mbi përvojën praktike të drejtësisë tranzitore në Shqipëri, studiuesit Robert C. Austin dhe Jonathan Ellison shkruajnë: “Meqenëse kishte përjetuar ndoshta format më të ashpra të komunizmit të Evropës, mund të mendohej se Shqipëria kishte arsyet më detyruese për të kryer një drejtësi të tranzicionit të qëndrueshme. Mund të mos ketë nevojë që të shikohen shumë biografite e udhëheqësve të tranzicionit të Shqipërisë për të pohuar se Shqipëria ka bërë pak në lidhje me të kaluarën. Ajo çka bëri Shqipëria është vetëm hakmarrje politike... Drejtësia e Shqipërisë paskomuniste lidhet me shkatërrimin përzgjedhës të së kaluarës, jo me përpjekjen për t’u marrë me të. ... Prej vitit 1991 deri në vitin 1997, kur ishin bërë disa përpjekje të pakta, procesi ishte i paorganizuar, i politizuar dhe i pasuksesshëm. ... U bënë spastrime shumë të mëdha të administratës publike pas fitores së Partisë Demokratike në mars të vitit 1992 dhe përsëri, kur Partia Socialiste fitoi zgjedhjet në vitin 1997, u bënë spastrime të mëdha në sektorin publik. Kjo gjë nuk mund të quhet lustracion, meqenëse është tërësisht në përputhje me kulturën politike të Shqipërisë së shekullit 20, e cila ia ka lënë gjithnjë derën të hapur mundësisë për të qenë një ditë hero dhe ditën tjetër tradhtar. Ky proces është

26 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Kthimi në Vendkujtesë”, broshurë, bot. 2019.

27 Jani, Jonida, Drejtësia e tranzicionit në Shqipëri: A mundet një komunitet jodemokratik të bëjë llogaritë me të kaluarën e tij?, OSBE, Drejtësia dhe ndryshimi në Shqipëri, bot. 2020, f. ??????

ndikuar shumë nga hakmarrja politike”.²⁸

Në një këndvështrim tjetër, studiuesit Gjergj dhe Mirela Sinani shkruajnë: “Edhe pas 30 viteve që Shqipëria ka pranuar sistemin demokratik, institucionet tona shtetërore, që pretendojnë se janë demokratike, vijojnë me një mungesë të theksuar vëmendjeje, kujdesi apo mbështetjeje për studime shkencore për të zbuluar të vërtetën e krimit komunist mbi popullin shqiptar. Vërejmë se, sapo dalin fakte për krimin komunist dhe sapo çelet një diskutim nga më normalët për të kuptuar situatën përkatëse, mobilizohet një arsenal i tërë propagandistik në emër gjoja të kritikës objektive. Sigurisht, kjo është një mënyrë tradicionale e përdorur gjatë diktaturës për t’i shkurajuar studiuesit dinjitozë të motivuar për kërkim shkencor dhe është një ndër arsytet se përse pak studiues qëndrojnë në këtë fushë kërkimi. ... Vërejmë se ka pak interes shtetëror për të dëgjuar dhe për të kuptuar faktet e zbuluara, aq më pak për t’i bërë të ditura në opinionin publik”.²⁹

Përpara se të analizojmë shkaqet që e kanë penguar procesin praktik të vendosjes së drejtësisë së tranzicionit në Shqipëri, është e nevojshme që të pranojmë se ai proces është shumë i vështirë për shkak të shumë arsyeve. Disa prej këtyre arsyeve lidhen me gjendjen problematike të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, përvojën dhe ekspertizën e munguar në fushën e drejtësisë së tranzicionit, mungesën e bashkërendimit ndër-institucional për kërkimin dhe gjetjen e viktimave të krimit komunist, mosinformimin e publikut shqiptar në lidhje me nevojën për vendosjen e drejtësisë së tranzicionit, interesat e veçantë vetjakë vetëmbrojtës të shkaktarëve të gjenocidit komunist dhe të familjarëve të tyre, mendësia e vjetër mbi zhvillimet historike e përhapur në opinionin publik shqiptar përgjatë komunizmit nëpërmjet librave shkollorë dhe propagandës zyrtare, mbështetja e dobët e studiuesve dhe njerëzve të interesuar për të kërkuar mbi krimet e diktaturës komuniste shqiptare, etj.

Megjithatë, vështirësia e këtij procesi nuk mund të jetë shkak themelor i pengimit të tij, krahasuar me mungesën e vullnetit politik të udhëheqjes paskomuniste shqiptare. Për mungesën e këtij vullneti politik flitet hapur nga gjithë studiuesit shqiptarë dhe të huaj, si dhe nga AIDSSH-ja.

Le të përmendim shkurtimisht vetëm disa nga faktet e mirënjohura.

Udhëheqësit e lartë ish-komunistë të fundit të viteve 1980 u dënuan vetëm me akuza për shpërdorime ekonomike vetjake dhe dënimet e tyre ishin qesharake, kurse një pjesë e tyre përfunduan me falje pas marrjes së pushtetit nga e majta, në vitin 1997. Për ta nuk u bë asnjë akuzë dhe nuk u dha asnjë dënim për dëmtim të rëndë të interesit kombëtar në ekonomi, në marrëdhëniet ndërkombëtare, ose në prishjen e koherencës së përbashkët shoqërore të shqiptarëve, duke mbjellë përçarje nëpërmjet luftës së klasave. Kuvendi i Shqipërisë nuk ka nxjerrë asnjëherë një ligj që të dënojë krimet e komunizmit, megjithëse janë bërë debate të shumta parlamentare dhe publike nëpërmjet mediave. Asnjë prej hetuesve dhe gjyqtarëve

²⁸ Robert C. Austin and Jonathan Ellison, “Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union”, ed. Lavinia Stan, Routledge, 2009, f. 176.
²⁹ AIDSSH, “Profile të ‘Armikut të popullit’ në diktaturë, f. 156-157.

të kohës së komunizmit nuk është gjykuar ose dënuar për përfshirje në torturat, vrasjet dhe krimet e tjera të diktaturës komuniste.

Në lidhje me mungesën e vullnetit politik të elitës politike paskomuniste, mund të bëhen shumë analiza dhe arsytetime. Përtej mungesës së vullnetit politik si shkaku kryesor i prapambetjes së drejtësisë tranzitore, duhen kërkuar edhe shkaqe të tjera. Elita politike shqiptare duhet analizuar në dy këndvështrime: në këndvështrimin e politikës së majtë dhe atë të politikës së djathtë.

Autorët Austin dhe Ellison bëjnë arsytetime të sakta dhe interesante mbi këtë prirje të mendësisë së elitës së re politike paskomuniste të Shqipërisë. Ata shkruajnë: “Para së gjithave, Shqipëria nuk ka pasur lëvizje disidente. Shqipëria krijoi një lëvizje disidente vetëm në kohën kur më në fund po afrohej përmbysja. Udhëheqësit antikomunistë dhe komunistët me mendime reformiste që u shfaqën në vitet 1990 dhe 1991 kishin pasur që të gjithë lidhje të fortë me komunizmin. Ashtu si në Rumani, ne po shikojmë një riprodhim të elitës, jo zëvendësim të elitës. Pra, shumë pak prej tyre ishin të gatshëm për të rrënuar më thellë se sa duhej në të kaluarën dhe edhe më pak kishin arsye që të bënin thirrje për një hapje të plotë të dosjeve të policisë. Megjithatë, atyre u duhej të punonin fort për të provuar se ishin antikomunistë. Dhe përfundimi ishte kërkimi shumë i politizuar për të bërë drejtësi”.³⁰

Për këtë arsye, e majta e politikës shqiptare paskomuniste, herë heshtte për krimet e komunizmit, herë mendohej t’i anashkalonte ose t’i zvogëlonte përmasat e tij me shprehje si “ashtu ishte koha, ligji”, etj. Në këto qëndrime, ajo është ndikuar ndoshta edhe nga njëfarë pragmatizmi i shprehur jo shumë hapur, i cili nënkuptonte se problemet e ndërlikuara të të përndjekurve politikë do të ishin, në fund të fundit, të përkohshme dhe do të zhdukeshin në mënyrë të natyrshme, bashkë me vetë njerëzit e brezit të parë të të përndjekurve, sipas ecurisë njerëzore të harresës. Në këtë qëndrim të së majtës politike ka ndikuar edhe interesi i saj për pushtet, duke dashur të mos humbasë vota prej mbështetësve tradicionalë. Për këtë arsye, pasi erdhi në pushtet për herë të parë, në fund të viteve 1990, kjo e majtë bëri disa amnisti edhe për ata pak të dënuar lehtë nga drejtësia tranzitore, të përmendur më sipër, që i përkisnin elitës së vjetër komuniste.

Mungesa e vullnetit politik tek e djathta e politikës shqiptare paskomuniste është shprehur në një formë të ndryshme. Ndoshta për shkak të mungesës së përvojës dhe dijeve në fushën e drejtësisë tranzitore, fillimisht e djathta është shprehur publikisht me idenë se të gjithë shqiptarët ishin “bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës” të regjimit të kaluar komunist, çka solli njëfarë zhgënjimi të shtresa e të përndjekurve politikë dhe familjarët e tyre. Në vitet e mëpasme, duke u mbështetur në miratimin e ligjeve përkatëse të lartpërmendura, që lidheshin me drejtësinë tranzitore, qeverisja e djathtë filloi edhe procesin e rehabilitimit dhe dëmshpërblimit të të përndjekurve politikë, por ky proces ecte shumë ngadalë, i ndikuar nga interesa klienteliste të politikës. Nuk ka pasur as përpjekje për të dënuar gjenocidin e motivuar politikisht të diktaturës komuniste, kurse proceset e ngritura kundër udhëheqjes së vjetër

30 Robert C. Austin and Jonathan Ellison, “Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union”, ed. Lavinia Stan, Routledge, 2009, f. 180.

komuniste u bënë vetëm të mbështetura mbi akuza ekonomike, siç e kemi përmendur më lart. Siç theksonte Imholtz: Askush nuk dyshonte se familja e Hoxhës jetonte mirë dhe gëzonte të mira që shqiptarët e tjerë nuk i kishin, por t'i bëje këto akuza subjektin e vetëm të procedimit penal dukej si diçka që i zvogëlonte shpërdorimet më serioze të regjimit të Hoxhës". Vendimi për t'i shndërruar krimet ekonomike në gjënë kryesore të drejtësisë paskomuniste mbështetej në faktin e thjeshtë se kjo ishte e lehtë dhe pak a shumë ishte gjithçka që kishin udhëheqësit e rinj. ... mund të thuhet me siguri se vendimi për të dalë kundër elitës së vjetër, duke u mbështetur mbi krimet ekonomike, ka qenë një gabim katastrofik për dy arsye: e para, ai i zhgënjente njerëzit e zakonshëm, të cilët prisnin që komunistët të përballeshin me drejtësinë, dhe e dyta, pas kësaj u bë thujtë e pamundur t'i përfshije njerëzit më vonë, kur më në fund u bënë akuza politike më serioze".³¹ Qeverisjet e djathta shqiptare ngurruan ta shqyrtojnë këtë problem me përparësi, duke bashkërenduar shumë institucione dhe duke bërë financimet përkatëse. Në këtë ngurrim të së djathtës ka ndikuar ndoshta edhe fakti se Shqipëria është një vend me popullsi të vogël dhe lidhjet fisnore e miqësore ndërmjet njerëzve janë të kudogjendura dhe të pavarura nga prirjet politike, duke e ngadalësuar në shumë raste forcën motivuese për kryerjen e drejtësisë tranzitore. Në ngadalësimin e forcës së vullnetit politik të së djathtës shqiptare në lidhje me krimin e së kaluarës komuniste kanë ndikuar edhe heqjet e shumta të njerëzve, të motivuara politikisht, nga administrata shtetërore në fillim të qeverisjes demokratike të vitit 1992, duke sjellë largimin e tyre. Kjo u duk shumë qartë në zgjedhjet vendore të vitit 1992, ku e djathta humbi shumë votues. Më vonë, kjo ndikoi edhe më shumë në ngadalësimin e përpjekjeve të së djathtës për procesin e drejtësisë tranzitore.

Janë pikërisht këto rrethana të përgjithshme, të lidhura me procesin e pamjaftueshëm të vendosjes së drejtësisë tranzitore në Shqipëri, që kanë ndikuar fort si shkak madhor edhe në çështjen, ende të pazgjidhur dhe aq serioze, si nga këndvështrimi i drejtësisë, ashtu dhe nga ai njerëzor, i të përndjekurve politikë të zhdukur nga regjimi i kaluar komunist. Ende sot, pas tridhjetë viteve si shoqëri demokratike pluraliste, ky vazhdon të jetë problem shumë shqetësues, që shfaqet në ngadalësimin e kërkimit, gjetjes dhe identifikimit të viktimave të gjenocidit të diktaturës komuniste.

Ndoshta duhet shtuar se edhe trysnia ndërkombëtare, sidomos ajo e Këshillit të Evropës, por edhe e institucioneve të tjera përkatëse ndërkombëtare, mund të kishte qenë më e fortë mbi autoritetet shqiptare, që këta të mund të ecnin si duhet në përpjekjet praktike të kryerjes së drejtësisë tranzitore.

Si rrjedhojë, "paaftësia e Shqipërisë për të zbatuar masa të plota të drejtësisë tranzitore e ka ruajtur, në mos shumëfishuar, polarizimin e shoqërisë mbi të shkuarën totalitare".³²

31 Robert C. Austin and Jonathan Ellison, "Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union", ed. Lavinia Stan, Routledge, 2009, f. 182.

32 Gjeta, Altin, "Tranzicioni pa drejtësi në Shqipërinë paskomuniste: Ndërlikimet e tij mbi kujtesën kolektive dhe promovimin e demokracisë", OSBE, Drejtësia dhe ndryshimi në Shqipëri, bot. 2020, f. 17.

VI. Sfidat madhore të së ardhmes

Kohët e fundit, Frederique Hanotier, zyrtarja e të Drejtave të Njeriut në Delegacionin e BE-së në Shqipëri, duke vlerësuar raportin e ICMP-së mbi njerëzit e zhdukur nën regjimin komunist në Shqipëri, ka thënë: “BE-ja është shumë e përkushtuar për mbështetjen e drejtësisë tranzitore në Shqipëri dhe sidomos të Autoritetit [AIDSSH, shën. i aut. T. Starova], nëpërmjet ICMP-së. Rritja e vetëdijes publike mbi pajtimin dhe trajtimi i çështjes së njerëzve të zhdukur gjatë periudhës komuniste ka rëndësi të jashtëzakonshme”.³³

Mbështetur në përpjekjet e bëra për kryerjen e këtij studimi, literaturën dhe dokumentet e shumta të shqyrtuara, mendojmë se ndoshta, në fushën e drejtësisë tranzitore, Shqipëria ka nevojë të përballet, më në fund, me disa sfida madhore:

- Dënimi me ligj i gjithë krimeve të diktaturës komuniste dhe aktorëve të tyre, nëpërmjet miratimit të tij me konsensus të gjerë politik ndërpartiak.
- Krijimi i një strukture bashkërenduese ndërinstytucionale për të ndjekur zgjidhjen e gjithë problematikës së drejtësisë tranzitore.
- Rishikimi dhe përmirësimi i ligjit mbi hapjen e dosjeve të ish Sigurimit të Shtetit për të zhdukur çdo pengesë apo të pavërtetë në lidhje me to.
- “Nxitja dhe mbështetja e studiuesve që t’i përkushtohen punës kërkimore mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe hedhjes dritë mbi të vërtetat e parrëfyera të dhunës së organizuar të regjimit komunist”.³⁴
- Sipërmarrja e një përpjekjeje të rëndësishme për rishkrimin e librave shkollorë të historisë me synimin që të ndriçojmë brezat e rinj për të mos e harruar të vërtetën tragjike të diktaturës komuniste.
- Mbështetja shtetërore e historianëve për të hedhur dritë mbi ngjarje dhe figura të rëndësishme të historisë së shqiptarëve, të cilat janë anashkaluar, keqvlerësuar ose penguar nga diktatura komuniste.
- Ngritja e një përmendoreje të rëndësishme përkushtuar viktimave të diktaturës komuniste, që të shërbejë si akt i rëndësishëm i kujtesës kolektive historike për popullin shqiptar, dhe sidomos për brezat e rinj.

33 ICMP Report, Press Release, 2 March, 2021

34 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AIDSSH], “Kërkimi shkencor”, broshurë, bot. 2019.

VII. Bibliografi

- AIDSSH, “Profile të ‘Armikut të Popullit’ në diktaturë”, Tiranë, bot. 2021.
- AIDSSH, “Udhërrëfyes Për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit”, bot. 2021.
- AIDSSH, “Sigurimi dhe shkencëtarët”, Sh. Botuese Onufri, 2021.
- AIDSSH, “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”, bot 2019,
- “An Introduction to Transitional Justice”, ed. Olivera Simiç, Routledge, 2017.
- Almanak [Almanac] (Volume 1). Tiranë: Autor: Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. (2014).
- Bernhard, M., & Kubik, J. (Eds.). (2014). Twenty years after communism: The politics of memory and commemoration. New York, NY: Oxford University Press.
- Butka, U. (1993, 20 janar). Ligji i pafajësisë: Një fitore tjetër e demokracisë [Innocence law: Another victory of democracy].
- Kopeček, M. (2011). The rise and fall of Czech post-dissident liberalism after 1989. *East European Politics and Societies: and Cultures*, 25(2), 244–271.
- Mink, G. (2017). Is there a new institutional response to the crimes of Communism? National memory agencies in post-communist countries: The polish case (1998–2014), with references to East Germany. *Nationalities Papers*, 45(6), 1013–1027.
- OSBE, “Drejtësia dhe ndryshimi në Shqipëri”, bot. 2020.
- Pervizi, L. (2014). Në rrrathët e ferrit: Album [In the circles of inferno: Album of drawings]. Tiranë: Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.
- Pllumi, At Zef, “Rrno vetëm për me tregue”, Sh. Botuese 55, bot. 2006.
- “Profile të ‘Armikut të Popullit’ në diktaturë”, Konferencë ndërkombëtare e organizuar nga AIDSSH-ja, Sh. Botuese Onufri, 2021.
- Saraçi, F. (2017). “Kalvari i grave në burgjet e komunizmit” [The suffering of women in communist prisons]. Tiranë: Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.
- “Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union”, ed. Lavinia Stan, Routledge, 2009.
- Zërat e Kujtesës [Voices of Memory] (Volume 1). Tiranë: Autor. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. (2015, January 31). Spaç
- Zërat e Kujtesës [Voices of Memory] (Volume 2). Tiranë: Autor. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. (2016).



Zërat e Kujtesës [Voices of Memory] (Volume 3). Tiranë: Autor. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. (2017).

Zërat e Kujtesës [Voices of Memory] (Volume 4). Tiranë: Autor. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. (2019, February 27). Virtual museum: Tepelena camp

Xhomaqi, E. (2017). Përtej harrimit [Beyond oblivion]. Tiranë: Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

